

**Nisma për Transparencën e Industrive Nxjerrëse**

## **Libër referencash**

**Mars 2005**



## Hyrje

### Tabela e lëndës

	Faqe
<b>Hyrje</b>	2
<b>Kapitulli 1: Parimet dhe kriteret e NTIN-ësë</b>	<b>3</b>
NTIN: në kontekst	3
NTIN: palët e interesuara	4
NTIN: parimet dhe kriteret	4
<b>Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime</b>	<b>8</b>
<b>Tipare të përgjithshme</b>	8
Fazat e zbatimit	8
Përmbledhje e veprimeve të rekomanduara dhe veprimeve plotësuese	10
<b>Nisja</b>	13
A. Anëtarësimi	13
B. Organizimi	15
C. Zhvillimi i procesit	20
<b>Zbatimi</b>	23
D. Publikimi dhe botimi	23
E. Shpërndarja e informacionit për publikun dhe diskutimi	31
<b>Shqyrtimi i zbatimit të NTIN-ësë</b>	33
F. Shqyrtimi	33
<b>Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse</b>	<b>34</b>
Tipare të përgjithshme	34
Përmbledhje e veprimeve të rekomanduara dhe veprimeve plotësuese të shoqërive	34
<b>Miratimi</b>	36
A. Anëtarësimi	36
B. Mbështetja ndërkombëtare	36
<b>Mbështetja në nivel kombëtar</b>	37
C1. Vendi zbatues	37
C2. Vendi jozbatues	39
<b>Terminologjia</b>	<b>40</b>
<b>Shtojcë</b>	

## **Hyrje**

Shembuj të modeleve të raportimit për naftën, gazin dhe  
minierat

42

## Hyrje

### Çfarë është NTIN-ja?

Në shumë vende, paratë e përfituara nga prodhimi i naftës, gazit dhe mineraleve janë të lidhura me varfërinë, konfliktin dhe korrupsionin. Këtu, kemi të bëjmë me atë që, zakonisht, përkufizohet si “mallkim i burimeve natyrore”, dhe që, shpeshherë, vjen si rezultat i mungesës së transparencës dhe llogaridhënies lidhur me pagesat që shoqëritë u bëjnë qeverive dhe me të ardhurat që marrin qeveritë prej këtyre shoqërive. Nisma për Transparencën e Industrive Nxjerrëse (NTIN) synon që të sigurojë transparencën dhe llogaridhënien që mungon. E ndërmarrë mbi baza vullnetare dhe e mbështetur nga një koalicion shoqërisht, qeverish, investitorësh dhe organizatash të shoqërisë civile, kjo nismë ndërthur në vetvete përpjekje të tjera që synojnë përmirësimin e transparencës së praktikës buxhetore të shtetit, duke nisur një proces që do t’u krijojë qytetarëve mundësitë për t’u kërkuar qeverive të tyre të japin llogari për përdorimin e këtyre të ardhurave.

#### **Transparenca dhe zhvillimi: rasti i São Tomé-së dhe Príncipe-s**

São Tomé dhe Príncipe është një nga prodhuesit më të vegjël të naftës në Afrikë. Një pjesë e madhe e popullsisë jeton aktualisht në varfëri, por qeveria ka konstatuar se – nëse menaxhohet në mënyrë transparente – shfrytëzimi i naftës ofron mundësinë për një ndryshim të vërtetë në jetën e njerëzve. Në dhjetor 2004, Presidenti Fradik de Menezes dekretoi një ligj që rregullon marrjen, investimin dhe përdorimin e të ardhurave nga nafta lidhur me nxitjen optimale të ecurisë ekonomike dhe sociale të vendit. Ligji parashikon të drejtën e publikut për informim për të gjithë derdhjet në llogarinë përkatëse. Gjatë nënshkrimit, Presidenti deklaroi: "Asgjë nuk do të fshihet, asgjë nuk do të çohet dëm."

### **Ky libër referencash**

Në bazë të përvojave të grumbulluara gjatë fazës pilot të NTIN-ësë, ky libër referencash përbën një udhëzues shpjegues për vendet që dëshirojnë ta zbatojnë nismën, si dhe për shoqëritë e palët e tjera të interesuara, që dëshirojnë ta mbështesin zbatimin e saj.

Kapitulli i parë bën një përshkrim të shkurtër të hartimit të NTIN-ësë, që nga paraqitja e saj në Samitin Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm, mbajtur më 2002, deri në fazën e tanishme të zbatimit (që nga marsi 2005), duke kaluar përmes fazës pilot (qershor 2003-mars 2005). Ky kapitull përcakton parimet dhe kriteret e NTIN-ësë, të cilat përbëjnë thelbin e zbatimit të NTIN-ësë për të gjithë vendet pjesëmarrëse.

Kapitulli i dytë paraqet shembuj të veprimeve që kanë ndërmarrë vendet gjatë fazës pilot, veprime këto që njëherazi përputhen me parimet dhe kriteret e NTIN-ësë, si dhe u përshtaten rrethanave të vendeve të veçanta.

Kapitulli i tretë përmban shembuj të ngjashëm për shoqëritë që mbështesin zbatimin e NTIN-ësë.

## Hyrje

Libri i referencave u përgatit nga Sekretariati Ndërkombëtar i NTIN-ësë pranë Ministrisë Britanike për Zhvillim Ndërkombëtar (MBZHN). Libri i referencave do të rishikohet në bazë të përvojës që do të përftohet në të ardhmen. Ministria Britanike për Zhvillim Ndërkombëtar vë në dispozicion informacion më të hollësishëm në adresën: [NTIN@dfid.gov.uk](mailto:NTIN@dfid.gov.uk) dhe në adresën e NTIN-ësë në internet: [www.eitransparency.org](http://www.eitransparency.org)

# Kapitulli 1

## Parimet dhe kriteret e NTIN-ësë

### NTIN: në kontekst

Nxitja e një transparence më të madhe dhe e detyrimit për më shumë llogaridhënie në vendet që varen nga të ardhurat e industrive të naftës, të gazit dhe minerare, lejon zbutjen e efekteve negative të mundshme të keqadministrimit të të ardhurave, me qëllim që këto të ardhura të bëhen faktikisht motori i një rritjeje ekonomike afatgjatë, që kontribuon për zhvillimin afatgjatë dhe uljen e varfërisë.

#### **Kur një vend konsiderohet i pasur në burime minerare?**

Sipas projektit “Udhëzues për transparencën e të ardhurave të burimeve” (dhjetor 2004) të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), një vend konsiderohet i pasur në hidrokarbure dhe/ose burime minerare nëse përmbush kriteret e mëposhtme: (i) një përqindje mesatare e të ardhurave që burojnë nga hidrokarburet dhe/ose mineralet përfaqëson të paktën 25% të të ardhurave të përgjithshme buxhetore për tre vitet e mëparshme; ose (ii) një përqindje mesatare e të ardhurave nga eksporti i hidrokarbureve dhe/ose mineraleve përfaqëson të paktën 25% të të ardhurave të përgjithshme nga eksporti për tre vitet e mëparshme.

Vendet e pasura në burime, shoqëritë e industrive nxjerrëse dhe komuniteti ndërkombëtar kanë të njëjtin interes për të mbështetur përpjekjet për rritjen e transparencës dhe forcimin e detyrimit për llogaridhënie. Shumë vende kanë bërë tashmë një progres të dukshëm në këtë fushë. Komuniteti ndërkombëtar i mbështet këto përpjekje. Më 2003, në Evian, vendet e G8-ës miratuan deklaratën “Luftë kundër korrupsionit dhe përmirësimi i transparencës”. Më 2004, në Ishullin Si, “Pakte për transparencën” u arritën me katër vende. FMN-ja, nëpërmjet “Kodit të praktikave të mira për çështje të transparencës së financave publike” dhe manualit shoqërues, nxit transparencën e financave publike në vendet anëtare, ndërsa ndjekja e ecurisë së zbatimit të Kodit sigurohet nga nxjerrja e “Raporteve për zbatimin e standardeve dhe kodeve (ROSCs)”. Si FMN, ashtu edhe Banka Botërore, me anë të këshillave për veprimet që duhen ndërmarrë, të huave të orientuara për politikatat e përgjithshme, të huave për projektet dhe të asistencës teknike, nxisin një administrim më efikas të të ardhurave që vijnë nga burimet.

Që përpjekjet, të cilat synojnë përmirësimin e qeverisjes, të marrin formë më të plotë, në shtator 2002, Toni Bler bëri prezantimin e NTIN-ësë. NTIN përbën një pikënisje të mirë për të thelluar analizën dhe diskutimin lidhur me menaxhimin e të ardhurave.

Që në fillim, NTIN pati mbështetje të gjerë ndërkombëtare, por analiza e vë theksin te niveli kombëtar. Pronësia e NTIN-ësë nga vendet dhe pjesëmarrja e shoqërive në të janë tregues i një angazhimi si në planin

## **Kapitulli 1: NTIN: parimet dhe kriteret**

kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar, lidhur me zbatimin e transparencës dhe të detyrimit për llogaridhënie në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe botën e tregtisë.

Avantazhet për vendet zbatuese janë arritur kryesisht në kuadrin – ose si pikënisje – e përpjekjeve më të mëdha për përmirësimin e qeverisjes. Qeverisja e mirë e të ardhurave që vijnë nga burimet, lejon përmirësimin e menaxhimit të këtyre të ardhurave dhe duhet të nxisë një stabilitet më të madh ekonomik dhe politik. Kjo, nga ana tjetër, mund të ndihmojë për të parandaluar konfliktet që prekin sektorët e naftës, të gazit dhe të minierave. Gjithashtu, ky proces bën të mundur përmirësimin e klimës për investime, sepse u tregon qartë investitorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare se qeveria është e angazhuar për një transparencë më të madhe.

Avantazhet, për shoqëritë dhe investitorët, e mbajnë zbutjen e risqeve në planin e politikave dhe të reputacionit. Paqëndrueshmëria politike që shkakton një qeverisje e pasigurt përbën një kërcënim të drejtëpërdrejtë për investimet. Duke qenë se investimet janë me intensitet të fortë kapitali dhe varësisht nga stabiliteti afatgjatë për të gjeneruar fitime në rastin e industrive nxjerrëve, zvogëlimi i një paqëndrueshmërie të tillë është i dobishëm. Gjithashtu, transparenca mund të kontribuojë për krijimin e një situatë të barabartë për të gjitha shoqëritë dhe, duke i bërë publike detyrimet që i paguan qeverisë, një shoqëri publikon kontributin që investimet e saj i sjellin vendit.

Avantazhet për shoqërinë civile kanë volumn më të madh të informacioneve të disponueshme në fushën publike për të ardhurat që qeveritë menaxhojnë në emër të qytetarëve, duke bërë kështu të mundur që këta të fundit ta kenë më të lehtë për t'i kërkuar qeverisë që të japë llogari.

## **NTIN: palët e interesuara**

Në nivel kombëtar, NTIN është një nismë e udhëhequr nga qeveria. Sidoqoftë, parimet dhe kriteret e NTIN-ësë parashikojnë përfshirjen aktive të partnerëve të tjerë nga shoqëria në tërësi. Udhëheqja dhe pjesëmarrja e gjerë në nivel vendor janë të domosdoshme dhe kërkohet angazhimi aktiv, publik i një game të gjerë aktorësh.

Termi “palë e interesuar” i referohet një individi, komuniteti, grupi apo organizate që interesohet për rezultatin e NTIN-ësë, përfshirë si ata që janë prekur prej saj (pavarësisht nëse ndikimi ka qenë pozitiv ose negativ), ashtu edhe ata që kanë qenë në gjendje të ushtrojnë ndikim (në mënyrë pozitive ose negative). Palët e interesuara gjenden në brendësi të institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Kategoria e palëve të interesuara përfshin aktorët kryesorë dhe palët e interesuara në kuptim më të gjerë, të cilët dallohen sipas nivelit të interesit dhe shkallës së ndikimit që ushtrojnë te zbatimi. Përbërja e grupit mund të ndryshojë nga njëri vend te tjetri, por, në të gjithë vendet, ka gjasa që të angazhohen aktorë të ngjashëm.

### **Kush mund të jetë palë e interesuar e NTIN-ësë?**

- Institucionet publike
  - Pushteti ekzekutiv

## Kapitulli 1: NTIN: parimet dhe kriteret

- Agjenci që janë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve natyrore
- Agjenci që janë përgjegjëse për grumbullimin dhe menaxhimin e të ardhurave
- Agjenci që janë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik, rregullimin e sektorit privat dhe të administratës publike
- Pushteti ligjvënës
  - Komisionet buxhetore dhe/ose të burimeve natyrore
  - Hallkat nën-kombëtare të qeverisë
- Institucionet e kontrollit të lartë
- Sektori privat
  - Shoqëritë që janë të pranishme në vend
    - Shoqëri publike kombëtare
    - Shoqëri publike ndërkombëtare
    - Shoqëri private kombëtare
    - Shoqëri private ndërkombëtare
  - Investitorët
  - Shoqatat e biznesit
- Shoqëria civile
  - Organizatat me bazë komuniteti
  - Organizatat joqeveritare kombëtare (OJQ-të)
  - OJQ-të ndërkombëtare dhe filialet e tyre vendore
  - Media, sindikatat, institucionet universitare dhe të kërkimit dhe organizatat me bazë fetare
- Zbatuesit e NTIN-ësë
  - Administratorët, revizorët dhe/ose agjencitë që bëjnë publikimin
- Partnerët ndërkombëtarë
  - Institucionet ndërkombëtare (FMN, Banka Botërore, Kombet e Bashkuara)
  - Donatorët

## NTIN: parimet dhe kriteret

Një numër i madh vendesh, shoqërisht dhe organizatash të shoqërisë civile morën pjesë në konferencën e *Lancaster House*-it, që u organizua në Londër (2003), nën kujdesin e Qeverisë së Britanisë së Madhe. Pjesëmarrësit miratuan një Deklaratë të Parimeve që synon të rrisë transparencën lidhur me pagesat dhe të ardhurat në sektorin e industrive nxjerrëse. Të njohura si Parimet e NTIN-ësë, ato përfaqësojnë gurin themeltar të kësaj Nisme.

Pas konferencës së *Lancaster House*-it, NTIN vazhdoi të siguronte mbështetje në nivel ndërkombëtar nga ana e qeverive, shoqërive të mëdha shumëkombëshe, investitorëve institucionalë, aktiveti nën menaxhim të të cilëve arrin afërsisht në 7 trilion dollarë amerikanë, organizatave joqeveritare dhe institucioneve ndërkombëtare.

## Kapitulli 1: NTIN: parimet dhe kriteret

Për më tepër, një numër vendesh – d.m.th., Azerbajxhani, Republika e Kongos, Gana, Republika Kirkize, Nigeria, São Tomé dhe Príncipe, Timor Leste dhe Trinidad e Tobago – filluan interpretimin dhe zbatimin e Parimeve, duke luajtur kështu një rol qendror në hartimin e NTIN-ësë. Ishte fjala për një fazë pilot të një rëndësie të madhe për NTIN-ë. Duke u frymëzuar nga Parimet, vendet zbatuese e kanë vendosur NTIN-ë në kuadrin e nismave të tjera kombëtare, kanë hartuar plane pune dhe kanë zbatuar procedura duke bërë të mundur që të përvetësohet procesi.

Gjatë kësaj faze, shumëllojshmëria e përvojave të zbatimit të NTIN-ësë ka bërë të mundur që nisma të përmirësohet më tej. Gjithashtu, kjo nisëm ka kontribuar në një debat më të gjerë për domosdoshmërinë e udhëzimeve të qarta lidhur me zbatimin, të cilat, sidoqoftë, respektojnë natyrën vullnetare të saj dhe specifikat e vendeve të ndryshme.

Pas përfundimit të fazës pilot, me qëllim që NTIN të mund të shtrihet në vende të tjera të pasura në burime, është e rëndësishme që të krijohet një tërësi Kriteresh të NTIN-ësë, të pranuar nga të gjithë vendet, të cilat dëshirojnë të vënë në zbatim NTIN-ë.

Në konferencën për NTIN-ë, mbajtur në Londër, më 2005, pjesëmarrësit miratuan kriteret, duke i inkurajuar vendet për t'i kapërcyer, ku është e mundur, këto kërkesa minimale. Ata konstatuan rëndësinë e vënies së mësimave të nxjerra nga faza pilot në dispozicion të vendeve zbatuese dhe të shoqërive që ofrojnë mbështetjen e tyre. Ata mirëpritën udhëzuesin për praktikën më të mira që parashtrohen në “Kodin e praktikave të mira për çështje të transparencës së financave publike” dhe në manualin për transparencën e financave publike. Nga ana tjetër, për pjesëmarrësit, libri i referencave për NTIN-ë përfaqëson një udhëzues plotësues, që ilustron modalitetet e zbatimit.

### Parimet e NTIN-ësë

1. Ne ndajmë të njëjtën bindje se shfrytëzimi me maturi i pasurive të burimeve natyrore duhet të përbëjë një motor të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike që kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm dhe uljen e varfërisë, por që, pa një menaxhim të mirë, mund të ketë impakte të padëshiruara në planin ekonomik dhe social.
2. Ne afirmojmë se menaxhimi i pasurive të burimeve natyrore në dobi të qytetarëve të një vendi është kompetencë e qeverive sovrane, e cila ushtrohet në interes të zhvillimit të tyre kombëtar.
3. Ne konstatojmë se avantazhet e nxjerrjes së burimeve shfaqen në formën e fluksit të të ardhurave duke u shtrirë në një periudhë relativisht të gjatë kohore dhe mund të varen shumë nga çmimi.
4. Ne konstatojmë se mirëkuptimi nga ana e publikut për të ardhurat dhe shpenzimet e qeverive në kohë, ka gjasa të kontribuojë në debatin publik dhe ta bëjë më të lehtë zgjedhjen e opsioneve të duhura dhe realiste që favorizojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
5. Ne nënvizojmë rëndësinë e transparencës, si dhe nevojën për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe respektimin e detyrimit për llogaridhënie nga ana e qeverive dhe shoqërive të industrive nxjerrëse.

## Kapitulli 1: NTIN: parimet dhe kriteret

6. Ne konstatojmë se është e nevojshme që t'i përqendrojmë forcat për arritjen e një transparence më të madhe në një kontekst të respektimit të kontratave dhe të ligjeve.
7. Ne konstatojmë se transparenca financiare është një mjet që ka gjasa të kontribuojë për përmirësimin e klimës për investime të drejtëpërdrejta të brendshme dhe të jashtme.
8. Ne besojmë në parimin dhe praktikën e përgjegjësisë së qeverisë përpara të gjithë qytetarëve përsa i përket administrimit të fluksit të të ardhurave dhe të shpenzimeve publike.
9. Ne jemi të angazhuar të inkurajojmë respektimin e standardeve të larta të transparencës dhe të përgjegjshmërisë në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe botën e biznesit.
10. Ne besojmë në domosdoshmërinë e një qëndrimi koherent dhe realist ndaj publikimit të pagesave dhe të të ardhurave, qëndrim ky që duhet të jetë i thjeshtë për t'u ndërmarrë dhe për t'u zbatuar.
11. Ne jemi të mendimit se publikimi i pagesave në një vend të caktuar duhet të përfshijë të gjitha shoqëritë e industrive nxjerrëse të pranishme në atë vend.
12. Kur bëhet fjalë për gjetjen e zgjidhjeve, ne vlerësojmë se të gjitha palët e interesuara - qeveritë dhe agjencitë e tyre, shoqëritë e industrive nxjerrëse, shoqëritë e shërbimit, organizatat shumëpalëshe, organizatat financiare, investitorët dhe organizatat joqeveritare – duhet të japin një kontribut përkatës të rëndësishëm.

### **Kriteret e NTIN-ësë**

1. Të gjitha pagesat me rëndësi materiale, që shoqëritë u bëjnë qeverive lidhur me shfrytëzimin e naftës, të gazit dhe mineraleve ("pagesat") dhe të gjitha të ardhurat me rëndësi materiale, që marrin qeveritë nga shoqëritë e naftës, gazit dhe minerare ("të ardhurat"), botohen dhe shpërndahen rregullisht për publikun e gjerë në formë lehtësisht të përdorshme, të plotë dhe të kuptueshme.
2. Atje ku nuk ekzistojnë auditime të tilla, pagesat dhe të ardhurat përbëjnë objektin e një auditimi të pavarur e të besueshëm, në përputhje me normat ndërkombëtare në fushën e auditimit.
3. Pagesat dhe të ardhurat kuadrohen në përputhje me normat ndërkombëtare në fushën e auditimit, nga një administrator i pavarur i besueshëm, i cili boton opinionin e tij për këtë kuadrim të llogarive dhe për mospërputhjet, nëse do të ketë të tilla.

4. Ky hap vlen për të gjitha shoqëritë, përfshirë shoqëritë shtetërore.

## Kapitulli 1: NTIN: parimet dhe kriteret

5. Shoqëria civile merr pjesë aktivisht në hartimin, ndjekjen dhe vlerësimin e këtij procesi dhe jep kontributin e saj në debatin publik.
6. Qeveria pritëse harton një plan publik pune, të realizueshëm financiarisht, lidhur me elementet e sipërpërmendura, me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare financiare kur është nevoja, plan ky që shoqërohet me objektiva të matshme, kalendarin e zbatimit dhe një vlerësim të kufizimeve të mundshme përsa i përket kapaciteteve.

## Kapitulli 2

### Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime


#### Tipare të përgjithshme

Të gjithë vendet, në të cilat industritë nxjerrëse zënë një vend të rëndësishëm, inkurajohen që të rrisin transparencën e menaxhimit të të ardhurave që nxirren nga shfrytëzimi i naftës, gazit dhe mineraleve. Vendet e pasura në burime inkurajohen më tej që të mos mjaftohen me miratimin e parimeve të NTIN-ësë, por të zbatojnë nismën. Zbatimi rigoroz i NTIN-ësë kërkon që qeveria të angazhohet si në planin politik, ashtu edhe në atë financiar. Gjithashtu, Sekretariati Ndërkombëtar i NTIN-ësë, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e zhvillimit ofrojnë mbështetje teknike dhe financiare për zbatimin e nismës në fazë të hershme.

Pasi ka zgjedhur që të marrë pjesë në NTIN-ë, çdo vend dhe sektor duhet të hartojë modelin e vet të zbatimit. Sidoqoftë, disa mësimet të përgjithshme mund të nxirren nga përvoja e fazës pilot.

#### Fazat e zbatimit

Siç tregon grafiku më poshtë, nisja, zbatimi dhe shqyrtimi janë tri fazat kryesore të NTIN-ësë. Çdo fazë përfaqëson një etapë kyç të procesit për sigurimin e transparencës së të ardhurave.



Translation  
ENGLISH  
endorse  
EITI  
Initiate  
Implement  
Review

ALBANIAN  
Miratimi  
NTIN  
Nisja  
Zbatimi  
Shqyrtimi

Pasi ka miratuar NTIN-ë, vendi kalon, në konsultim me palët kryesore të interesuara, te **nisja**, duke ngritur struktura vendimmarrëse, duke hartuar një plan pune dhe duke bërë të mundur krijimin e kapaciteteve dhe financimin e qëndrueshëm të programit. Faza tjetër, domethënë, **zbatimi**, përbën thelbin

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

e NTIN-ësë. Qeveria, shoqëritë dhe organizatat e shoqërisë civile kanë secila një rol të rëndësishëm për të luajtur në nivelin e publikimit, përhapjes dhe diskutimit të të ardhurave të deklaruara. Krijimi i një klime besimi bëhet shumë më i lehtë kur nga ky proces arrihet një konsensus. Faza e tretë përfshin **shqyrtimin** e procesit të zbatimit. Pikërisht në këtë çast, evokohen problemet dhe mundësitë e përmirësimit me qëllim orientimin e vendimeve dhe veprimeve të ardhshme.

**Nisja:** A është arritur konsensus për hartimin dhe planifikimin e nismës?

Në këtë fazë, i takon qeverisë që ta çojë përpara nismën, duke marrë masat për të ngritur strukturat dhe për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve vendimmarrëse, personelin dhe mekanizmat e financimit. Si rregull i përgjithshëm, këto nuk kërkojnë veprime apo kosto të jashtëzakonshme. Qeveria duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të hyrë në kontakt, që në fillim, me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e industrisë. Një vend e ka nisur NTIN-ë pasi palët kryesore të interesuara të kenë rënë dakort për objektivat, arritjet dhe planin e ardhshëm të punës e të procesit të një vendi që dëshiron të vërë në zbatim NTIN-ë.

**Zbatimi:** A janë të botuara në formë të besueshme dhe të plotë pagesat dhe të ardhurat e industrive nxjerrëse?

Një vend e zbaton NTIN-ë kur ai është i aftë të demonstrojë, me angazhimin e plotë të palëve kryesore të interesuara, ekzistencën e një cikli të rregullt të publikimit, përhapjes dhe diskutimit të të ardhurave të industrive nxjerrëse. Të gjithë vendet zbatuese duhet të veprojnë në përputhje me parimet dhe kriteret e NTIN-ësë, megjithëse modeli i saktë i zbatimit në një vend të caktuar duhet të ketë parasysh kontekstin kulturor dhe ligjor të atij vendi.

**Shqyrtimi:** A është parashikuar informacioni i përvitshëm i palëve të interesuara përse i përket procesit të zbatimit?

Është e rëndësishme që zbatimi i NTIN-ësë të përmirësohet me kalimin e kohës, duke u bazuar në përvojën e krijuar. Qeveritë duhet ta mundësojnë këtë proces duke krijuar kushtet dhe strukturat e nevojshme në mënyrë që palët e interesuara të thonë fjalën e tyre për planet e ardhshme. Organizatat e shoqërisë civile duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me qeverinë dhe industrinë nxjerrëse, me qëllim që të sigurojnë mbikëqyrjen plotësuese të procesit. Për shembull, një shqyrtim i zbatimit të NTIN-ësë mund të çojë te hartimi sërish i procesit vendimmarrës, zëvendësimi i përfaqësuesve të palëve të interesuara dhe përshtatja e programeve për krijimin e kapaciteteve.

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

### Përmbledhje e veprimeve të rekomanduara dhe veprimeve plotësuese

Tabela më poshtë paraqet një udhëzues për vendet që po zbatojnë kriteret e NTIN-ësë. Informacioni bazohet në mësimet që janë nxjerrë nga zbatimi i saj në Nigeri, Azerbajxhan, Ganë dhe Republikën e Kirgizisë.

**Veprimet e rekomanduara** (me sfond blu) konsiderohen të rëndësishme për një zbatim efikas, ndërsa **veprimet plotësuese** (me sfond të gjelbër) lidhen me veprimtaritë e mëtejshme që mund të ndërmerren për të përmirësuar zbatimin.

Veprime të rekomanduara	Veprime plotësuese
<b>Nisja</b>	
<b>A. Anëtarësimi</b>	
1. A i ka përcaktuar qeveria palët kryesore të interesuara?	A1. A ka ndërmarrë qeveria ndonjë vlerësim zyrtar të palëve të interesuara dhe a i ka përcaktuar ajo elementet nxitës, fizibilitetin dhe ndikimin e zbatimit të NTIN-ësë?
2. A ka bërë qeveria ndonjë deklaratë publike, të qartë, lidhur me qëllimin e saj për të zbatuar NTIN-ën?	
3. A e ka studjuar qeveria kuadrin ligjor për të përcaktuar ndonjë pengesë të mundshme lidhur me zbatimin e NTIN-ësë?	A3. A e ka botuar qeveria në adresën e saj të internetit informacionin ekzistues për të ardhurat?
<b>B. Organizimi</b>	
4. A ka emëruar qeveria ndonjë person për të drejtuar zbatimin e NTIN-ësë? A është bërë ndonjë njoftimi publik për këtë emërim?	
5. A e ka parashikuar qeveria pjesëmarrjen e drejtuesve të lartë të ministrive dhe shërbimeve përkatëse në organet vendimmarrëse të NTIN-ësë?	
6. A është angazhuar qeveria në favor të drejtimit të NTIN-ësë nga përfaqësues qeveritarë të nivelit të lartë?	
7. A ka krijuar qeveria ndonjë strukturë vendimmarrëse e të përcaktuar qartë për NTIN-ën?	
8. A ka miratuar qeveria ndonjë plan pune për zbatimin e NTIN-ësë?	

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

9. A siguron përbërja e komisioneve zyrtare një përfaqësim të ekuilibruar të interesave të palëve të ndryshme të interesuara?	A9. A përfshihen përfaqësuesit e shoqërive dhe të organizatave të shoqërisë civile në përbërje të komisioneve për NTIN-ë të nivelit të lartë?
9a. A ka përcaktuar dhe krijuar qeveria mekanizma kontakti për një përzgjedhje më të gjerë të palëve të interesuara?	
10. A ka përcaktuar dhe krijuar qeveria burime të financimit të qëndrueshëm për zbatimin e NTIN-ësë?	A10. A e ka siguruar qeveria disponueshmërinë e kapitalit themeltar pranë organizatave ndërkombëtare?
11. A ka kërkuar qeveria që t'i sensibilizojë agjencitë qeveritare, si dhe aktorët e tjerë kryesorë dhe palët e interesuara lidhur me NTIN-ë?	
<b>C. Zhvillimi i procesit</b>	
12. A janë shumica e palëve kryesore të interesuara dakord me procesin e hartimit të modeleve të deklarimit?	A12. A janë marrë masa për t'i ndihmuar palët e interesuara që t'i kuptojnë modelet e deklarimit dhe t'i plotësojnë ato?
13. A është emëruar ndonjë administrator, i cili të konsiderohet nga shumica e palëve kryesore të interesuara i paanshëm dhe i besueshëm?	
14. A janë marrë masa për të siguruar financim të qëndrueshëm për rolin e administratorit?	
15. A janë përcaktuar nevojat në fushën e krijimit të kapaciteteve të palëve kryesore të interesuara?	
16. A janë marrë masa për realizimin e programeve zyrtare dhe jozyrtare për krijimin e kapaciteteve përpara publikimit?	
<b>Zbatimi</b>	
<b>D. Publikimi dhe botimi</b>	
17. Çfarë duhet publikuar, kush do ta realizojë këtë dhe si?	
17a. Cilat janë flukset e avantazheve që duhen publikuar?	A17a. A mund të deklarohen flukse të tjera avantazhesh në baza fakultative?
17b. Çfarë duhet bërë që të gjitha shoqëritë të paraqesin deklarime?	
17c. Në ç'mënyre qeveritë dhe shoqëritë do t'i paraqesin deklarimet e tyre?	

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

18. A janë të besueshme raportet e paraqitura për pagesat dhe të ardhurat?	
18a. Nëse auditime të tilla nuk ekzistojnë tashmë, a është përcaktuar ndonjë shoqëri apo a janë përcaktuar shoqëri auditimi për të kryer një auditim të besueshëm dhe të pavarur të pagesave dhe të të ardhurave?	
19. Në ç'mënyre do ta përgatisë administratori Raportin për NTIN-ë?	A19a. A është përcaktuar ndonjë marzh gabimi në kuadrin e procesit të paraqitjes së deklarimeve?
	A19b. A janë marrë masa që të mund të bëhet një auditim i pavarur i shifrave të deklaruara nëse ky kërkohet nga shumica e palëve të interesuara?
20. Në ç'mënyrë do të bëhet publik Raporti për NTIN-ë?	
20a. A është e nevojshme që, në Raportin për NTIN-ë, të paraqiten të dhëna totale apo të zbërthyer sipas zërave?	
<b>E. Shpërndarja e informacionit për publikun dhe diskutimi</b>	
21. A është Raporti për NTIN-ë i arritshëm dhe i kuptueshëm?	
21a. A e lejojnë procedurat përhapjen e rezultateve në shkallë të gjerë?	
22. A kanë marrë pjesë palët kryesore të interesuara në ndonjë diskutim të rezultateve lidhur me të ardhurat dhe pagesat e deklaruara?	A22. A është shtrirë ky diskutim në kuptim më të gjerë të palët e interesuara?
<b>Shqyrtimi</b>	
<b>F. Shqyrtimi</b>	
23. A janë marrë masa për ndjekjen dhe vlerësimin e NTIN-ësë?	A23a. A ekziston ndonjë mekanizëm formal i vlerësimit të pavarur?
	A23b. A u janë ofruar përvoja vendeve të tjera dhe palëve të interesuara?
24. A është ndikuar hartimi i procesit vendimmarrës dhe proceseve të tjera nga mekanizmat e dhënies së informacionit apo komenteve?	

### Nisja

#### A. Anëtarësimi

##### **Veprim i rekomanduar 1: A i ka përcaktuar qeveria palët kryesore të interesuara?**

Parimet e NTIN-ësë parashtrojnë se të gjitha palët e interesuara, përfshirë qeveritë dhe agjencitë e tyre, shoqëritë e industrive nxjerrëse, shoqëritë e shërbimit, organizatat shumëpalëshe, institucionet financiare, investitorët dhe organizatat joqeveritare, japin një kontribut përkatës të rëndësishëm për zbatimin. Është e rëndësishme që aktorët kryesorë dhe palët e interesuara në kuptim më të gjerë të përcaktohen që në fillim të procesit. Përbërja e grupit mund të ndryshojë nga njëri vend te tjetri, por ajo duhet të sigurojë përfaqësimin e të gjitha palëve, angazhimi i të cilave është i domosdoshëm për zbatimin me sukses të nismës.

Është e rëndësishme që palët e interesuara të përcaktohen dhe kontakti me to të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim zbatimin efikas të nismës. Angazhimi, pronësia dhe besueshmëria e NTIN-ësë në një vend të caktuar varen nga vlerësimi që i bëjnë palët kryesore të interesuara avantazheve dhe momentit të përshtatshëm të nismës.

##### **Rast studimor 1**

Në Nigeri, 28 anëtarët e Grupit Kombëtar të Punës të Palëve të Interesuara (GKPPI) përfaqësojnë palët kryesore të interesuara, që janë përcaktuar së bashku. Bëhet fjalë për shoqërinë civile (2), mediat (1), asamblenë kombëtare (2), asamblenë e shteteve (2), shoqëritë kombëtare dhe shumëkombëshe të naftës (3), sektorin privat të organizuar (4) dhe qeverinë federale (14).

##### **Veprim plotësues A1: A ka ndërmarrë qeveria ndonjë vlerësim zyrtar të palëve të interesuara dhe a i ka përcaktuar ajo elementet nxitës, fizibilitetin dhe ndikimin e zbatimit të NTIN-ësë?**

Në vende të caktuara, palët e interesuara janë relativisht në numër më të vogël dhe, rrjedhimisht, është më e lehtë për t'i përcaktuar. Sidoqoftë, në shumë vende të tjera, ku madhësia dhe kompleksiteti i sektorit sjell si pasojë shtimin e palëve të interesuara, rekomandohet një analizë më e plotë dhe formale e këtyre palëve dhe e elementeve nxitës të vënies në jetë të NTIN-ësë, me qëllim që të orientohet vendimmarrja e vendit përsa i përket modaliteteve të zbatimit të NTIN-ësë.

##### **Veprim i rekomanduar 2: A ka bërë qeveria ndonjë deklaratë publike, të qartë, lidhur me qëllimin e saj për të zbatuar NTIN-ë?**

Për të nisur procesin e sensibilizimit të publikut, qeveria duhet të bëjë dhe të botojë në mediat vendore një deklaratë publike, të qartë, për

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

angazhimimin e saj në favor të parimeve dhe të vënies në jetë të NTIN-ësë.

Deklarata e angazhimit lidhur me zbatimin, në vend që të kufizohet me miratimin e NTIN-ësë, duhet të tregojë masat që qeveria ka marrë ose do të marrë brenda një kuadri kohor të arsyeshëm (dhe të përcaktuar) për të përmbushur kriteret e NTIN-ësë. Kjo deklaratë duhet të bëhet nga Kryetari i Shtetit ose ndonjë përfaqësues i qeverisë, i caktuar posaçërisht.

Qeveria është e interesuar që të krijojë në internet një adresë kombëtare për NTIN-ë, në të cilën duhet botuar dhe kjo deklaratë. Një kopje e deklaratës duhet t'i dërgohet Sekretariatit Ndërkombëtar të NTIN-ësë, me qëllim që ai ta botojë në adresën e vet të internetit.

### Veprim i rekomanduar 3: A e ka studjuar qeveria kuadrin ligjor për të përcaktuar ndonjë pengesë të mundshme lidhur me zbatimin e NTIN-ësë?

Meqenëse NTIN përputhet pa krijuar probleme me kuadrin ligjor të administratës fiskale që funksionon mirë dhe parashikon mekanizmat e kontrollit financiar, ajo nuk duhet të sjellë detyrime të jashtëzakonshme për qeverinë.

Sidoqoftë, në rast se nuk ndodh kështu, duhen marrë masa të tjera: garantimi i NTIN-ësë me ligj, miratimi i politikave dhe ligjeve të reja lidhur me transparencën, të ardhurat dhe industrinë, ose ndryshimi i politikave dhe ligjeve ekzistuese lidhur me NTIN-ë. Në qoftë se kërkohen ndryshime të tjera ligjore, qeveria fillimisht duhet të sigurohet që ligjet ekzistuese të jenë të qarta dhe koherente. Qeveritë mund të parashikojnë që, në ligjet anti-korrupsion, të përfshihet transparenca e menaxhimit të të ardhurave që vijnë nga industrinë nxjerrëse, ose ta plotësojnë këtë transparencë me masa kundër korrupsionit ku të parashikohet mbrojtja ligjore të zyrtarëve, të cilët denoncojnë praktika që bien ndesh me të mirën publike.

#### Rast studimor 2

Në Republikën e Kirgizisë, duhen shpallur ligje të veçanta për të autorizuar auditimin e pavarur të shoqërive shtetërore.

Në Azerbajxhan, nuk kërkohet që të bëhen ndryshime në legjislacionin, por Memorandum i Mirëkuptimit (MM) mes palëve të ndryshme të interesuara ka forcën e ligjit.

#### Rast studimor 3

Në Nigeri, një projektligj për NTIN-ë plotëson legjislacionin e propozuar për çështje të përgjegjësisë financiare dhe të lirisë së informacionit.

### Veprim plotësues A3: A e ka botuar qeveria në adresën e saj të internetit informacionin ekzistues për të ardhurat?

Sado të paplota që të jenë shifrat, botimi i të ardhurave të njohura, më saktë të atyre që vijnë nga sektori i industrive nxjerrëse, mund të shërbejë si referim për të gjykuar përparimin në fushën e përmirësimit të cilësisë së të dhënave. Do të ishte ideale që qeveria ta botojë këtë informacion në adresën

## **Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime**

e saj të internetit, në një vend të qartë në adresën kombëtare për NTIN-ë. Ky raport i parë për të ardhurat që vijnë nga industrinë nxjerrëse, është garanci e angazhimit të qeverisë lidhur me transparencën.

## B. Organizimi

**Veprim i rekomanduar 4: A ka emëruar qeveria ndonjë person për të drejtuar zbatimin e NTIN-ësë? A është bërë ndonjë njoftim publik për këtë emërim?**

Qeveria duhet të emërojë një person të rangut të lartë, i cili gëzon besimin e të gjitha palëve të interesuara, për të drejtuar vënie në jetë të NTIN-ësë. Meqenëse kjo normalisht nënkupton bashkëpunimin e disa ministrive dhe agjencive, personi në fjalë duhet të jetë i autorizuar për menaxhimin e këtij procesi.

Deri më sot, këta përfaqësues janë zgjedhur në ministrinë ose shërbimet përkatëse. Ata nganjëherë kanë nevojë për mbështetjen e një zëvendësuesi dhe të personelit, por krijimi i një njësie të veçantë nuk është përherë e nevojshme. Në të gjitha rastet, përgjegjësitë e rolit të bashkërendimit duhet të jenë të përcaktuara saktë dhe personi në fjalë duhet të jetë i lirë t'i ushtrojë funksionet e tij në mungesë të ndikimit politik të pajustificueshëm. Pas krijimit të një adrese kombëtare për NTIN-ë në internet, aty duhet të shfaqen emri dhe koordinatat e personit me qëllim që atij dhe qeverisë t'u kërkohej që të japin llogari.

**Rast studimor 4**

Në Ganë, termat e hollësishme të referencës të Sekretariatit të NTIN-ësë, njësi e vacante kjo e krijuar në Ministrinë e Minierave që shërben si pikë qendrore bashkërendimi, janë në dispozicion të publikut.

**Veprim i rekomanduar 5: A e ka parashikuar qeveria pjesëmarrjen e drejtuesve të lartë të ministrive dhe shërbimeve përkatëse në organet vendimmarrëse të NTIN-ësë?**

Duke ditur se kuadrot e lartë kanë një kalendar shumë të ngjeshur, NTIN kërkon bashkëpunimin e të gjitha ministrive dhe agjencive qeveritare si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel rajonal. Prandaj, është e rëndësishme që qeveria të konfirmojë përfaqësimin e një grupi specifik kuadros të lartë në komisionet zyrtare.

**Veprim i rekomanduar 6: A është angazhuar qeveria në favor të drejtimit të NTIN-ësë nga përfaqësues qeveritarë të nivelit të lartë?**

**Rast studimor 6**

Në Republikën e Kirgizisë, Komiteti Këshillimor për NTIN-ë kryesohet nga Kryeministri, ndërsa Zëvendësministri i Financave kryeson Komitetin Ekzekutiv për NTIN-ë dhe drejton nismën në tërësi.

**Rast studimor 5**

Në Republikën e Kirgizisë, Komisioni për NTIN-ë ka në përbërjen e tij dhe këshilltarët kryesorë të Kryeministrit, si dhe zyrtarët më të lartë të Ministrive të Financave, Industrisë dhe Tregtisë, të Punëve të Jashtme dhe të Drejtësisë

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Shpeshherë, mbështetja e vazhdueshme ndaj drejtuesve të lartë politikë ka ndihmuar për të ruajtur dinamizmin e NTIN-ësë dhe për të zgjidhur çështjet që dalin gjatë zbatimit.

### **Veprim i rekomanduar 7: A ka krijuar qeveria ndonjë strukturë vendimmarrëse e të përcaktuar qartë për NTIN-ë?**

Vendimet lidhur me NTIN-ë duhet të merren në konsultim me një numër të caktuar palësh të interesuara, organizatash, përfaqësuesish të sektorëve dhe partnerë të ndryshëm. Cilado që të jetë struktura e qeverisjes që zgjidhet për të vënë në jetë NTIN-ë, qeveria duhet të bëjë kujdes që përgjegjësitë dhe rolet vendimmarrëse të jenë të përcaktuara qartë, dhe që konsultimi dhe vendimmarrja të jenë të bashkërenduara mirë.

#### **Rast studimor 7**

Në Ganë, Komiteti Ekzekutiv (KE) ka 17 anëtarë: 12 përfaqësues të qeverisë, një shoqatë industriale që përfaqëson ndërmarrjen, përfaqësues të donatorëve dhe një grup të shoqërisë civile. Nga ana e tij, KE organizon një “tryezë të rrumbullaktë” për të diskutuar pikëpamjet e ndryshme lidhur me NTIN-ë dhe për t'i transmetuar KE-së komentet.

#### **Rast studimor 8**

Në Azerbajxhan, palët e ndryshme të interesuara kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi, i cili përcakton rolet dhe detyrimet e tyre përkatëse. Ai është publikuar në në adresën kombëtare për NTIN në internet: [http://www.oilfund.az/doc/memorandum\\_e\\_n.doc](http://www.oilfund.az/doc/memorandum_e_n.doc)

### **Veprim i rekomanduar 8: A ka miratuar qeveria ndonjë plan pune për zbatimin e NTIN-ësë?**

Për të treguar angazhimin e saj në favor të zbatimit të NTIN-ësë, qeveria duhet të bjerë dakord me palët kryesore të interesuara për një plan pune që do t'i vihet në dispozicion publikut. Një plan pune për ndjekjen e zbatimit duhet të parashikojë, mes të tjerash, krijimin e kapaciteteve të qeverisë, të industrive dhe të OJQ-ve vendore, masa që synojnë të mundësojnë kuadrumin e pagesave dhe të ardhurave, dhe vlerësimin e ecurisë në raport me objektivat e caktuara për çdo aktor së bashku me kostot dhe afatet, për të cilat është rënë dakord.

Është e parapëlqyeshme që ky plan pune të botohet në adresën kombëtare për NTIN-ë në internet, në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të informohen paraprakisht për veprimet dhe procedurat e parashikuara, veçanërisht për ato që kanë të bëjnë me krijimin e kapaciteteve, krijimin e marrëdhënieve dhe shpërndarjen e rezultateve.

### **Veprim i rekomanduar 9: A siguron përbërja e komisioneve zyrtare një përfaqësim të ekuilibruar të interesave të palëve të ndryshme të interesuara?**

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Duke patur parasysh numrin pa dyshim të rëndësishëm të palëve të interesuara, ndërkohë që komiteti i bashkërendimit patjetër duhet ta kufizojë numrin e anëtarëve të vet, duhet marrë një vendim pragmatik lidhur me përbërjen e komitetit, me qëllim që ai të respektojë larminë, përfshirjen dhe përfaqësimin e palëve të ndryshme të interesuara.

### Rast studimor 9

Nigeria, duke dashur të sigurojë një përfaqësim të madh të palëve të interesuara brenda grupit të punës, e ndryshoi përbërjen fillestare me qëllim që të përfshiheshin mediat, sindikatat dhe një avokat. Anëtarët pritet që të tregojnë besueshmërinë e nevojshme dhe të akreditohen nga grupi që ata përfaqësojnë.

Veprim plotësues A9: A përfshihen përfaqësuesit e shoqërive dhe të organizatave të shoqërisë civile në përbërje të komisioneve për NTIN-ë të nivelit të lartë?

Niveli i përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të shoqërive brenda komiteve për NTIN-ë ndryshon nga njëri vend te tjetri, gjë që dëshmon për dallimet në planin e motivimit të palëve të interesuara dhe të rezultateve të pritshme nga zbatimi. Sidoqoftë, përgjithësisht, mendohet se një përfaqësim i nivelit të lartë të shoqërisë civile dhe i sektorit privat rrit efektshmërinë e komiteve.

Përveç një përfaqësimi të nivelit të përshtatshëm, është gjithashtu e dobishme që anëtarësia të jetë e qëndrueshme ose, kur kjo nuk është e mundur, të bëhet kujdes që organizatat të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre duke u dhënë informacion të plotë anëtarëve të rinj.

**Veprim i rekomanduar 9a: A ka përcaktuar dhe krijuar qeveria mekanizma kontakti për një përzgjedhje më të gjerë të palëve të interesuara?**

Në planin e qeverisjes, duhet të ekzistojë një mënyrë që të gjitha palët e interesuara, të përcaktuara gjatë fazës së *anëtarësimit*, t'i përfaqësojnë interesat e tyre në kuadrin e hartimit të NTIN-ësë. Në mënyrë të veçantë, është e rëndësishme që shkalla e shtrirjes të përfshijë ndërmarrjet e vogla e të mesme dhe organizatat e shoqërisë civile dhe, në vend që të kufizohet në kryeqytet, të përfshijë shoqëritë brenda rajoneve.

Siç përmendet më sipër, qeveria ka interes që të krijojë një adresë kombëtare për NTIN-ë në internet. Aty mund të botohen të gjitha informacionet lidhur me organizimin e procesit të NTIN-ësë, qeverisjen dhe shkallën e shtrirjes.

### Rast studimor 10

Disa palë të interesuara mendojnë se Komiteti Ekzekutiv në Ganë duhet të zgjerohet me përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në interes të angazhimit të këtij grupi, përfaqësimi mund të organizohet nëpërmjet ndonjë shoqate sektoriale.

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

### Veprim i rekomanduar 10: A ka përcaktuar dhe krijuar qeveria burime të financimit të qëndrueshëm për zbatimin e NTIN-ësë?

Me qëllim që procesi i zbatimit të jetë i qëndrueshëm, me kalimin e kohës qeveria duhet të përcaktojë sa më shpejt që të jetë e mundur një burim kombëtar të financimit të qëndrueshëm. Mund të parashikohet që kostot e NTIN-ësë të mbulohen me të ardhurat nga nafta ose mineralet, mundësisht pas një periudhe të caktuar të nisjes: pas tre cikleve të para të raportimit, për shembull.

#### Rast studimor 11

Në Nigeri, projektligji për NTIN-ë propozon një linjë buxhetore për mbështetjen e zbatimit të NTIN-ësë. Qeveria e Kirgistanit, për auditimin e shoqërisë shtetërore minerare ka përdorur një pjesë të vogël të të ardhurave nga shitja e një aksioni të qeverisë në një minierë. Në Azerbajxhan, shoqëritë dhe qeveria parashikojnë t'i paguajnë kostot me radhë.

### Veprim plotësues A10: A e ka siguruar qeveria disponueshmërinë e kapitalit themeltar pranë organizatave ndërkombëtare?

Organizatave ndërkombëtare dhe disa vende janë angazhuar t'u ofrojnë mbështetjen e duhur në planin financiar, teknik apo diplomatik, vendeve të NTIN-ësë që nga fazat e para të hartimit të saj. Duke qenë se kjo mbështetje e jashtme mund të jepet, mes të tjerave, për gjallërimin e takimeve mes partnerëve të NTIN-ësë apo dërgimin e konsulentëve teknikë për të mbështetur vënien në jetë, ajo nuk duhet të dobësojë pronësinë e procesit nga qeveria pritëse. Është e nevojshme që të studjohet mënyra për ta bërë të qëndrueshme mbështetjen pas dhënies fillestare.

#### Rast studimor 12

Në Ganë, DFID ka dhënë mbështetjen e saj për një konferencë të rëndësishme për prezantimin e NTIN-ësë, e cila:

- Ka përmirësuar imazhin e NTIN-ësë dhe e ka nxjerrë atë më shumë në pah brenda vendit.
- Ka shkëmbyer informacione për situatën aktuale të NTIN-ësë në vende të tjera pilot.
- Ka konstatuar statusin e ecursë së zbatimit të NTIN-ësë në vend.
- Ka përcaktuar mundësitë dhe kufizimet e ecursë së NTIN-ësë.

### Veprim i rekomanduar 11: A ka kërkuar qeveria që t'i sensibilizojë agjencitë qeveritare, si dhe aktorët e tjerë kryesorë dhe palët e interesuara lidhur me NTIN-ë?

Duke qenë se NTIN është një proces që i përket qeverisë, është e rëndësishme që ajo të sensibilizojë fillimisht organizmat përkatëse qeveritare

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

(Ministritë e Naftës apo të Minierave, Ministrinë e Financave, Institucionin e Lartë të Aduditimit). Agjencitë përkatëse qeveritare duhet të bëjnë kujdes që Dokumentet e Strategjisë për Uljen e Varfërisë, si dhe diskutimet e

### **Rast studimor 13**

Gjatë një ankete për idetë dhe njohuritë për palët e interesuara në Nigeri, anketuesve (përfshirë punëtorë të industrisë së naftës, afaristë e afariste, si dhe mësues) iu bë pyetja: “Kush përfiton nga një fuçi naftë dhe sa?” Sipas mendimit të përgjithshëm, nëse kostoja e një fuçie naftë është 30 dollarë amerikanë, kostoja e prodhimit është 5 dollarë amerikanë, qeveria fiton 5 dollarë amerikanë dhe pjesën tjetër prej 20 dollarësh amerikanë e merr shoqëria.

konsultimet përpara shkrimit të atyre dokumenteve, të mbajnë parasysh çështjet e të ardhurave nga burimet natyrore. Njëkohësisht, qeveria duhet të ndërmarrë një program të qëndrueshëm të krijimit të kapaciteteve të palëve kryesore të interesuara. Çështjet e të ardhurave që sigurohen nga industritë nxjerrëse mund jenë pak të njohura ose të keqkuptohen në shumë vende (shih Rastin studimor 13). Në vendet që po zbatojnë aktualisht NTIN-ë, qeveritë kanë ndërmarrë një sërë programesh për sensibilizimin dhe krijimin e kapaciteteve për një grup më të gjerë palësh të interesuara. Këto programe mund të lidhen me pjesëmarrjen e mediave në prezantimin e NTIN-ësë, me shtjellimin e një strategjie të komunikimit publik për ministrinë përkatëse ose integrimin në programin mësimor të shkollave publike, të prezantimit të rëndësishëm si të të ardhurave nga burimet, ashtu edhe të detyrimit të qeverive për të dhënë llogari.

## **C. Zhvillimi i procesit**

**Veprim i rekomanduar 12: A janë shumica e palëve kryesore të interesuara dakord me procesin e hartimit të modeleve të deklarimit?**

Shembujt e modeleve të deklarimit (kampionë të të cilëve janë bashkëlidhur si shtojca të librit të referencave) janë përpiluar për publikimin e të ardhurave në kuadrin e NTIN-ësë. Gjatë zbatimit të NTIN-ësë, vendet pritet që t'i rishikojnë dhe t'i zgjerojnë modelet me qëllim që ato të kenë parasysh situatat dhe kërkesat specifike të vendit dhe sektorit.

Në disa vende, me detyrën e bashkërendimit të ndryshimeve të modeleve të deklarimit ngarkohet një person apo një organizatë, rast në të cilin është e rëndësishme që jo vetëm të sigurohen kapacitetet teknike të këtij të fundit, por edhe të bëhet kujdes që ai, i cili gëzon besimin e palëve të interesuara, të jetë i arritshëm.

**Veprim plotësues A12: A janë marrë masa për t'i ndihmuar palët e interesuara që t'i kuptojnë modelet e deklarimit dhe t'i plotësojnë ato?**

Diskutimi dhe shqyrtimi i objektit të publikimit të deklarimit nganjëherë kufizohen nga mungesa e njohurive teknike, të cilat bëjnë të mundur interpretimin e hollësive të flukseve të ndryshme të të ardhurave nga nafta dhe veprimtaria minerare dhe përlogaritjen e tyre të saktë.

**Veprim i rekomanduar 13: A është emëruar ndonjë administrator, i cili të konsiderohet nga shumica e palëve kryesore të interesuara i paanshëm dhe i besueshëm?**

**Rast studimor 14**

Në Azerbajxhan, u krijua një komision i veçantë, i përbërë nga përfaqësues të qeverisë, të shoqërive dhe të OJQ-ve, për të drejtuar procesin e tenderimit dhe për të emëruar një administrator të pavarur (rol që aktualisht e luan një firmë auditimi), të ngarkuar me përpilimin e shifrave për pagesat dhe të ardhurat.

Është e nevojshme që të emërohet një administrator për të grumbulluar dhe vlerësuar të dhënat për të ardhurat që paraqesin shoqëritë dhe qeveria. Është thelbësore që palët e interesuara të kenë besim në paanshmërinë dhe kompetencën e administratorit. Në këtë funksion, mund të jetë një firmë private auditimi, një individ ose një organizëm zyrtar ekzistues ose i krijuar posaçërisht, që

konsiderohet nga të gjithë si i pavarur nga qeveria dhe i paprekur nga ndikimi i saj.

Konflikti i interesit apo perceptimi i konfliktit të interesit mund të paraqesë vështirësi. Në qoftë se, për shembull, administratori i emëruar është një shoqëri auditimi që merret tashmë me auditimin e njëres prej shoqërive deklaruese, nëse kjo lidhet me një përfaqësues qeveritar që merret me flukset e të ardhurave, mund të lindë dyshimi për ekzistencën e një konflikti.

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

### **Veprim i rekomanduar 14: A janë marrë masa për të siguruar financim të qëndrueshëm për rolin e administratorit?**

Në vartësi të nivelit të hollësive që kërkohet nga palët e interesuara, procesi i përpilimit ose auditimit të të dhënave për të ardhurat, paraqitur nga tërësia e agjencive qeveritare përkatëse dhe gjithë shoqëritë e industrive nxjerrëse, mund të bëhet mjaft i ndërlikuar, çka nuk do të kalojë pa pasoja në planin e shpenzimeve. Edhe kur financimi fillestar vjen nga një burim i jashtëm, qeveria ka interes që të përcaktojë, që në fillim, një burim të financimit të qëndrueshëm.

### **Veprim i rekomanduar 15: A janë përcaktuar nevojat në fushën e krijimit të kapaciteteve të palëve kryesore të interesuara?**

Modalitetet e deklaramit në kuadrin e NTIN-ësë duhet të jenë të lehta për t'u kuptuar, në mënyrë që të minimizohen nevojat për krijimin e kapaciteteve për njerëzit që duhet të përdorin raportet. Megjithatë, që procesi të jetë i besueshëm, është e rëndësishme që palët kryesore të interesuara të kuptojnë mekanizmat e deklaramit.

Krijimi i kapaciteteve nuk është një çështje e thjeshtë e ndjekjes apo auditimit të kompetencave. Qeveria, organizatat e shoqërisë civile dhe, në disa raste, aktorët industrialë kanë kërkuar asistencë për ngritjen e rrjeteve dhe krijimin e kapaciteteve logjistike, teknike dhe vendimmarrëse, për të ditur “atë çka duhet kërkuar” në transaksionet industriale dhe si duhet t'u përcillet mesazhi aktorëve qeveritarë dhe industrialë.

#### **Rast studimor 15**

Në Nigeri, janë përcaktuar tashmë disa nevoja për krijimin e kapaciteteve, ndër të cilat:

- krijimi i kapaciteteve teknike të organizatave të shoqërisë civile që ato të mund ta luajnë rolin e tyre aktual në një mënyrë më efikase;
- krijimi i kapaciteteve teknike të palëve deklaruese, me qëllim që të mund të plotësojnë modelet e deklaramit;
- krijimi i kapaciteteve logjistike të qeverisë për të organizuar sistemet e ekzekutimit;
- krijimi i kapaciteteve të qeverisë në fushën e ngritjes së rrjeteve për një bashkërendim më të mirë të përpjekjeve;
- krijimi i njohurive teknike, të cilat bëjnë të mundur të kuptohen të ardhurat nga industritë e naftës dhe veprimtarisë minerare, elementet bazë të menaxhimit financiar, rolet dhe përgjegjësitë;
- përmirësimi i kapaciteteve të OJQ-ve dhe të shoqërive në fushën e vendimmarrjes dhe arritjes së konsensusit.

### **Veprim i rekomanduar 16: A janë marrë masa për realizimin e programeve zyrtare dhe jozyrtare për krijimin e kapaciteteve përpara publikimit?**

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Duhet kohë që të zgjidhen nevojat e përcaktuara në planin e kapaciteteve, të cilave u duhet kushtuar rëndësi sa më shpejt që të jetë e mundur. Përpara zbatimit, duhet të ndërmerren programe të përshtatura të sensibilizimit dhe krijimit të kapaciteteve lidhur me aspekte të rëndësishme të NTIN-ësë.

### **Rast studimor 16**

Në Nigeri, ka donatorë ndërkombëtarë që, deri tani, kanë ofruar 90% të financimit të destinuar për krijimin e kapaciteteve të shoqërisë civile që ajo të mbështesë vënien në jetë të NTIN-ësë. Sidoqoftë, organizatat e shoqërisë civile e kuptojnë mirë nevojën për të siguruar burime të ardhurash të qëndrueshme dhe shpresojnë të marrin këshilla në fushën e zhvillimit të fushatave për grumbullimin e fondeve në nivel vendor.

Kjo do të mundësojë përmirësimin e procesit që në fillim, ndërsa përfaqëson një lloj “fitore të lehtë” për vendet që kërkojnë të demonstrojnë angazhimin e tyre lidhur me zbatimin. Ashtu si në rastin e vetë zbatimit, është e rëndësishme që për këto programe të përcaktohen burime financimi të qëndrueshëm.

## Zbatimi

### D. Publikimi dhe botimi

**Veprim i rekomanduar 17: Çfarë duhet publikuar, kush do ta realizojë këtë dhe si?**

Gjatë fazës së *nisjes*, duhet të përcaktohet procesi i hartimit të modeleve të deklarimit, për shoqëritë dhe qeveritë, dhe duhet të përcaktohet një administrator i ngarkuar me nxjerrjen e Raportit për NTIN-ë. Në fillim të zbatimit, është e rëndësishme që të përcaktohet saktë objekti dhe natyra e publikimit që duhet përfshirë në deklarimet.

Krijimi i kapaciteteve është i nevojshëm me qëllim që të gjitha palët e interesuara të mund të marrin pjesë në këtë diskutim. Më shpesh, aktorët kryesorë janë qeveria dhe shoqëritë, por rekomandohet që të bëhet çdo përpjekje me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve në fjalë.

#### **Rast studimor 17**

Çështje lidhur me objektin e modeleve të deklarimit në Nigeri:

- A janë kostot joteknike të tilla që përfshijnë edhe kostot e sigurisë?
- Në ç'mënyrë pasqyrohen tatimi në burim në një auditim kur shoqëri të caktuara mbajnë 3% për të krijuar infrastrukturalen e nevojshme?
- A deklarohen shpenzimet që bëjnë shoqëritë për zhvillimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore, si dhe për pagesën e pagave të tjera, si "shpenzime prodhimi" apo si një investim social i shoqërisë?

#### **Rast studimor 18**

Në Ganë, organizatat që bëjnë publikimin kanë pranuar të bëjnë publike shumat e të ardhurave dyvjeçare. Renta e pasurisë minerare, tatimi mbi të ardhurat në burim, kuotimi për rindërtim dhe tarifa të tjera të ndryshme përfshihen te flukset e të ardhurave. Përveç kësaj, shoqëritë partnere kanë vendosur të botojnë kontributet për komunitetet – të zbërthyera në zëra të veçantë sipas sektorëve (arsim, shëndetsi, infrastrukturalen) – që në vitin 2002.

Vendimi lidhur me objektin e deklarimit ka gjasa të kushtëzohet nga regjimi financiar që, në shumë raste, përkon me kontratën e shpërndarjes së prodhimit. Në qoftë se palët e interesuara janë të mendimit se duhet të përfshihen edhe disa kosto të pranueshme (siguria, formimi, infrastrukturalen), hollësitë gjenden te shënimet bashkëlidhur. Në përgjithësi, raportet për NTIN-ë mund të përshkruajnë në mënyrë të dobishme se në çfarë mase kostot në themel të flukseve të avantazheve kanë qenë objekt i auditimeve të pavarura.

**Veprim i rekomanduar 17a: Cilat janë flukset e avantazheve që duhen publikuar?**

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Me fluks avantazhi kuptohet çdo burim i mundshëm avantazhi ekonomik, që merr qeveria pritëse nga një industri nxjerrëse. Këto flukse nuk supozohet të përfshijnë avantazhe ekonomike të drejtëpërdrejta, të tilla si ndërtimi i infrastrukturës apo punësimi i personelit vendor.

Të gjitha fluksat e avantazheve materiale duhet të deklarohen. Një fluks avantazhi konsiderohet me rëndësi materiale nëse Raporti përfundimtar për NTIN-ë rrezikon të pësojë shtrembërime për shkak të mungesës së tij ose të deklarimit të tij të gabuar.

Rekomandohet që një fluks avantazhi të cilësohet me rëndësi materiale nëse ai përfaqëson:

Alternativa 1: mbi A% të vlerës së përgjithshme të prodhimit të vlerësuar nga qeveria gjatë periudhës së deklarimit;

Alternativa 2: mbi B% të vlerës së përgjithshme të prodhimit të vlerësuar nga shoqëria në vendin pritës gjatë periudhës së deklarimit; ose,

Alternativa 3: mbi C milion dollarë amerikanë [ose D milion monedhë vendase].

Shembuj të flukseve të avantazheve:

Fluksi i avantazheve	Përshkrim i hollësishëm
E drejta e qeverisë pritëse për prodhimin	Bëhet fjalë për pjesën e prodhimit të përgjithshëm që i rezervohet qeverisë pritëse. Kjo e drejtë mund t'i transferohet drejtëpërsëdrejti qeverisë pritëse ose shoqërisë shtetërore kombëtare. Gjithashtu, ky fluks mund të jetë ose në natyrë dhe/ose me para në dorë.
E drejta e shoqërisë shtetërore kombëtare për prodhimin	Bëhet fjalë për pjesën e prodhimit të përgjithshëm që i rezervohet shoqërisë shtetërore kombëtare. Kjo e drejtë buron nga pjesa e kapitalit të shoqërisë. Ky fluks mund të jetë ose në natyrë dhe/ose me para në dorë.
Tatimi mbi fitimin	Ky është tatim mbi fitimin nga veprimtaritë nxjerrëse të shoqërisë.
Rentë e pasurisë minerare	Marrëveshjet për rentën e pasurisë minerare ndryshojnë në funksion të regjimit financiar të qeverive pritëse.  Për shembull, një shoqëri mund të jetë e detyruar të shesë të gjithë prodhimin dhe t'ia kalojë qeverisë një pjesë të të ardhurave nga shitja.  Në raste të tjera, qeveria pritëse ka një interes më të drejtëpërdrejtë për prodhimin bazë dhe nxjerr dispozita për shitje pavarësisht nga koncesionari. Kjo "rentë e pasurisë minerare" ngjan më shumë me të drejtën e një qeverie pritëse për prodhimin.

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Fluksi i avantazheve	Përshkrim i hollësishëm
Dividendët	Dividendët që i derdhen qeverisë pritëse si aksionare e shoqërisë shtetërore kombëtare lidhur me aksionet apo gjithë shpërndarjen e fitimeve lidhur me të gjitha format e kapitalit përveç huave ose kapitalit hua.
Bonuse (nënshkrimi, zbulimi, prodhimi)	Pagesat lidhur me bonuset për sa më poshtë ose në vlerësim të sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>shpërblime, grante dhe transferta të drejtave të nxjerrjes;</li> <li>realizimi i niveleve të caktuara të prodhimit ose arritja e objektivave të caktuara; dhe,</li> <li>zbulimi i rezervave/depozitave plotësuese të mineraleve.</li> </ul>
Tarifa për leje, tarifa për qira, “të drejtat e hyrjes” dhe shpërblime të tjera për leje dhe/ose koncesione	Pagesa për qeverinë pritëse dhe/ose shoqërinë shtetërore kombëtare për: <ul style="list-style-type: none"> <li>pranimin dhe/ose filimin e zbulimit dhe/ose mbajtjen e një lejeje ose një koncesioni (tarifa për lejen/tarifa për koncesionin);</li> <li>realizimin e punës së zbulimit dhe/ose grumbullimit të të dhënave (“të drejtat e hyrjes”). Këto pagesa kanë gjasa të kryhen gjatë fazës përpara prodhimit.</li> <li>dhënien me qira ose marrjen me qira të koncesionit ose zonës së shfrytëzimit.</li> </ul>
Avantazhe të tjera të rëndësishme për qeveritë pritëse	Tatimi mbi të ardhurat, prodhimin ose fitimin e shoqërive janë pjesë e këtyre flukseve të avantazheve, të cilat përjashtojnë tatimet mbi konsumin, siç janë taksa e vlerës së shtuar, tatimin mbi të ardhurat personale ose tatimin mbi shitjet.

Për të siguruar transparencë të plotë, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar vlerësimit të flukseve të avantazheve në natyrë, ku, nga ana tjetër, mund të ndodhin mospajtme të dukshme. Për shembull, Republika e Kongos përdor “çmimin financiar” (një çmim i vendosur për fuçi) për kalimin e “kostove në dollarë” në “kosto në fuçi” me qëllim që të bëjë përlllogaritjen e fuçive të fitimit që do të ndahen sipas kushteve të kontratave për ndarjen e prodhimit. Në qoftë se në modelet e referimit përdoret një çmim i tillë reference, do të duhej që ai të shoqërohej me shënime që tregojnë kush e ka shitur naftën, kush ka përfituar nga shitja, cili çmim është arritur dhe cili ka qenë raporti mes këtij çmimi dhe çmimit të referencës. Përveç kësaj, shënimet mund të bëjnë krahasimin e çmimeve të referencës, që janë përdorur, me çmimet e referencës të pranuar në shkallë ndërkombëtare.

Veprim plotësues A17a: A mund të deklarohen flukse të tjera avantazhesh në baza fakultative?

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Ka nganjëherë flukse avantazhesh që nuk janë shumë të rëndësishme, por që shoqëritë ose qeveritë pritëse dëshirojnë t'i deklarojnë vullnetarisht. Në rast se identifikohen flukse të tilla avantazhesh, është e rëndësishme që të bëhet kujdes që deklarimi i tyre të mos ndikojë te ajo sesi kuptohet informacioni i paraqitur.

### **Veprim i rekomanduar 17b: Çfarë duhet bërë që të gjitha shoqëritë të paraqesin deklarime?**

Qeverive u duhet të studiojnë mënyrat më të mira për të verifikuar që të gjitha shoqëritë e paraqesin deklarin e tyre në kohën e duhur dhe duke ndjekur modelet e deklarin, për të cilat është rënë dakord. Nëse, në disa vende, mjafton të arrihen marrëveshje vullnetare me shoqëritë, në vende të tjera mund të jetë i nevojshëm krijimi i një kuadri ligjor. Mund të pritët që qeveritë, të cilat zbatojnë NTIN-ë, të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë e tyre ligjore për t'i detyruar shoqëritë që të bashkëpunojnë. Përveç kësaj, ato mund të parashikojnë që ta vënë bashkëpunimin për NTIN-ë si kusht për çdo kontratë me një shoqëri të re ose ekzistuese.

Detyrimi për të paraqitur deklarin për NTIN-ë duhet të jetë i vlefshëm për të gjitha shoqëritë e industrive nxjerrëse (përfshirë shoqëritë ndërkombëtare, kombëtare dhe shtetërore), të cilat janë të pranishme në vend. Një subjekt (shfrytëzues i vogël) duhet të përjashtohet nga ky detyrim vetëm në qoftë se ai është në gjendje të tregojë, me një shkallë të lartë sigurie, se shumatat që deklaron do të jenë sidoqoftë të papërfillshme.

Disa qeveri mund të kenë dëshirë ta deklarojnë shumën e flukseve të avantazheve që burojnë nga këta shfrytëzues të vegjël. Kur kjo përfaqëson një pjesë të rëndësishme të të ardhurave të përgjithshme që janë marrë, vendosja e një niveli të përshtatshëm është me rëndësi themelore.

### **Veprim i rekomanduar 17c: Në ç'mënyrë qeveritë dhe shoqëritë do t'i paraqesin deklarin e tyre?**

Diskutimi për projekt-modelet e deklarin duhet të çojë në një marrëveshje për parimet dhe trajtimet e kontabilitetit të deklarimeve në kuadrin e NTIN-ësë, në mënyrë që të jetë e mundur të bëhet krahasimi i informacionit që vjen nga shoqëritë me atë që vjen nga qeveria pritëse.

Dallimet në nivel të periudhave kontabël, monedhave dhe njësive mund të jenë burimi i mospërputhjeve të ligjshme, të cilat i tejkalojnë shumë marzhet e gabimit, të pranuar normalisht, mes situatës së konsoliduar të të ardhurave të qeverisë dhe situatës së konsoliduar të kontributeve të shoqërive. Për të pakësuar mospërputhjet e ligjshme dhe për të shmangur vonesën në procesin e publikimit, këto shumore duhet të normalizohen me anë të ndonjë procedure kontabiliteti, për të cilën është rënë dakord bashkarisht.

Përvoja që do të grumbullohet gjatë zbatimit, pa dyshim, do ta bëjë të

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

mundur përmirësimin e këtyre udhëzuesve.

**Sistemi kontabël:** Meqenëse qeveritë pritëse, përgjithësisht, nuk janë në gjendje që të bëjnë vlerësimin e akumulimit të të ardhurave që priten nga shoqëritë për një periudhë të caktuar, rekomandohet që të gjitha njësitë të mbajnë llogarinë e arkës.

Meqenëse për raportet e rregullta të shoqërive përdoret metoda e kontabilitetit të aktivitetit, auditorëve të shoqërive mund t'u kërkohej që të përfshijnë një deklaratë për kuadrumin e pagesave në dorë me informacionin për kontabilitetin në pasqyrat e tyre financiare.

**Monedha në të cilën duhen bërë deklaratimet:** Qeveritë dhe shoqëritë duhet të bien dakord lidhur me monedhën në të cilën duhen bërë deklaratimet.

Në rastin e sektorit mineral, ku shumica e flukseve të avantazheve paguhen në monedhë vendase, rekomandohet që kjo e fundit të përdoret si njësi kontabiliteti, ndërsa njësia e kontabilitetit për sektorin e hidrokarbureve duhet të jetë dollari amerikan, meqenëse kursi i tregut jepet në dollar amerikan.

Sidoqoftë, vendet mund të zgjedhin që t'i botojnë pagesat dhe të ardhurat e NTIN-ësë si në monedhë vendase ashtu edhe në dollarë amerikanë – që shifrat të jenë më të kuptueshme për popullsinë vendase, për shembull.

Për transaksionet që kryhen në monedha të tjera, përveç njësisë së kontabilitetit, rekomandohet që për kalimin në monedhën në të cilën duhen bërë deklaratimet, të përdoret kursi mujor ose tremujor i këmbimit.

**Periudha kontabël:** Meqenëse shumica e shoqërive të naftës, gazit dhe pasurive minerare i paraqesin deklaratimet e brendshme një herë në muaj ose në tre muaj dhe deklaratimet e jashtme një herë në vit, duhet rënë dakord për periudhat kohore, që janë më të përshtatshme për subjektet deklaruese.

Deklarimet për NTIN-ë duhet të përgatiten të paktën një herë në vit, por në disa raste mund të jetë më e udhës që ato të përgatiten dy herë në vit.

Paraqitja e modeleve të plotësuara të deklaratimit: Shoqëritë dhe qeveria kanë interes për ta sinkronizuar sa më shumë që të jetë e mundur dorëzimin e deklarimeve nga ana e administratorëve të tyre, me qëllim që të garantojnë besueshmërinë e procesit.

Për më tepër, deklaratimet duhet të paraqiten në kohën e duhur. Sa më e gjatë të jetë koha për përgatitjen e deklarimeve, aq më pak të dobishme janë ato për qëllime të debateve politike lidhur me pagesat dhe të ardhurat e deklaruara.

**Veprim i rekomanduar 18: A janë të besueshme raportet e paraqitura për pagesat dhe të ardhurat?**

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

Besueshmëria e procesit të NTIN-ësë varet nga besueshmëria e të dhënave lidhur me pagesat dhe të ardhurat që shoqëritë dhe qeveria i paraqesin administratorit.

Rekomandohet që procesi të mbështetet, sa më shumë që të jetë e mundur, te procedurat dhe institucionet ekzistuese, si dhe te standardet ndërkombëtare. Në praktikë, procesi mund të jetë si më poshtë:

- Shoqëritë i marrin një revizori të jashtëm një mendim, sipas të cilit informacioni, që parashikojnë ta paraqesin për qëllim të NTIN-ësë, përputhet me pasqyrat e tyre financiare. Kjo mund të jetë një kërkesë për “procedura të veçanta”, e cila i bashkëlidhet termave të referencës për auditimin e jashtëm. Personat e ngarkuar për të kryer auditimin duhet t’i përafrojnë paraqitjet e llogarisë së arkës të shoqërive me pasqyrat e tyre financiare, të përgatitura sipas metodës së kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara. Kërkohet që në fushën e auditimit të respektohen normat përkatëse ndërkombëtare.
- Gjithashtu, revizori i qeverisë duhet të japë një opinion për saktësinë e llogarive të paraqitura nga qeveria.

**Veprim i rekomanduar 18a: Nëse auditime të tilla nuk ekzistojnë tashmë, a është përcaktuar ndonjë shoqëri apo a janë përcaktuar shoqëri auditimi për të kryer një auditim të besueshëm dhe të pavarur të pagesave dhe të të ardhurave?**

Të gjithë pagesat dhe të ardhurat që deklarohen në kuadrin e NTIN-ësë duhet të bëhen objekt i një auditimi të pavarur e të besueshëm. Kur shoqëritë paraqesin të dhëna për pagesat që janë verifikuar nga revizori i tyre i pavarur, normalisht nuk ka nevojë për ndonjë auditim tjetër. Kur nuk janë bërë auditime të tilla, apo nëse auditimi nuk konsiderohet i besueshëm, duhet kaluar te auditimi, mundësisht duke e emëruar revizorin pas një procedure konkurrimi të pavarur.

**Veprim i rekomanduar 19: Në ç’mënyrë do ta përgatisë administratori Raportin për NTIN-ë?**

Administratori i përcaktuar gjatë fazë së *nisjes* merr deklaratimet e shoqërive dhe të qeverisë dhe përpiqet t’i përafrojë llogaritë, përkatësisht, të shoqërive dhe të qeverisë, për të krijuar bazën e Raportit për NTIN-ë të vendit zbatues. Lidhur me Raportin për NTIN-ë mund të kërkohet pikëpamja e një revizori të pavarur.

Duhet rënë dakort lidhur me një procedurë për shqyrtimin e mospërputhjeve apo parregullsive në Raportin për NTIN-ë. Nëse kuadrimi i llogarive kërkon të bëhen ndryshime të deklaratimeve, këto duhet të miratohen, sipas rastit, nga revizori i jashtëm i shoqërisë ose nga revizori i qeverisë. Në rastin e parregullsive të mëdha e të pazgjdhshme duhen diskutuar masat që

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

duhen marrë.

### Rast studimor 19

Në Azerbajxhan, “kompetencat e revizorit” përcaktojnë procedura për menaxhimin e mospërputhjeve dhe parregullsive që kapërcejnë një marzh gabimi, për të cilin është rënë dakord:

(a) Në rast parregullsish, komisioni duhet ta pajisë shoqërinë e auditimit me një analizë të hollësishme të shumës së përgjithshme dhe shumës së zbërthyer në zëra të veçantë, sipas shoqërive të veçanta.

(b) Në rast se kjo analizë nuk mundëson zgjidhjen e parregullsive të konstatuara, shoqëria e auditimit informon subjektet deklaruese përkatëse dhe u kërkon të paraqesin dokumentacion mbështetës përsa i përket shifrave që kanë dhënë.

Veprim plotësues A19a: A është përcaktuar ndonjë marzh gabimi në kuadrin e procesit të paraqitjes së deklarimeve?

Pasi bien dakord për standardizimin e procesit të deklarimit, palët kryesore të interesuara, përpara zbatimit, duhet të bien dakord për një marzh gabimi të pranueshëm lidhur me çdo mospërputhje që konstatohet nga administratori mes kontributeve të derdhura nga industritë nxjerrëse dhe të ardhurave nga nxjerrja që ka marrë qeveria pritëse.

### Rast studimor 20

Dhoma e Llogarive e Republikës Kirkize ka vendosur që marzhi i gabimit në çështjen e mospërputhjeve mes shifrave të qeverisë dhe industrive nxjerrëse të mos e kalojë 1%.

Disa palë të interesuara të NTIN-ësë, duke patur parasysh faktin se fazat e para të çdo programi apo nisme të re shpeshherë karakterizohen nga një numër i caktuar gabimesh, arsyetojnë se marzhi i pranuar i gabimit në ciklin e parë të deklarimit duhet të jetë më i madh, apo se duhet përgatitur, pa e botuar, një raport “verifikimi”, i cili përcakton dhe menaxhon “mospërputhjet e justifikueshme”, me qëllim që të shmanget polemika e panevojshme publike.

Veprim plotësues A19b: A janë marrë masa që të mund të bëhet një auditim i pavarur i shifrave të deklaruara nëse ky kërkohet nga shumica e palëve të interesuara?

Në disa vende, shqetësimi lidhur me besueshmërinë e auditimeve ekzistuese apo procesin e deklarimit mund të bëjë që palët e interesuara të kërkojnë emërimin e një revizori të pavarur për të grumbulluar dhe për të vlerësuar të dhënat që kanë paraqitur shoqëritë dhe qeveria për pagesat dhe të ardhurat.

Edhe kur merret vendim që të mos

### Rast studimor 21

Në Nigeri, të gjithë palët kanë rënë dakord se, për të konsoliduar besimin e publikut, pagesat që deklarohen në kuadrin e NTIN-ësë duhet të bëhen objekt auditimi. Është marrë vendim për procesin e përzgjedhjes së revizorit të pavarur dhe tenderi publik është deklaruar i hapur.

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

bëhet një auditim i dytë i deklarimeve tashmë të verifikuara, asgjë nuk e pengon administratorin që të përdorë të dhënat e shoqërisë apo të qeverisë, nëse kjo gjë është e nevojshme për të kuadruar mospërputhjet e deklarimeve lidhur me pagesat dhe të ardhurat.

### Veprim i rekomanduar 20: Në ç'mënyrë do të bëhet publik Raporti për NTIN-ë?

Palët e interesuara duhet të bien dakord lidhur me caktimin e përgjegjësisë për publikimin e rezultateve të zbatimit të NTIN-ësë. Gjithashtu, në disa raste, administratori mund të ngarkohet me bërjen publike, por, deri më sot, përgjithësisht, është parapëlqyer që të emërohet një organizatë e ndryshme.

Cilado qoftë organizata (apo personi) e ngarkuar me publikimin e rezultateve, shumica e palëve të interesuara duhet ta konsiderojnë atë si të paanshme dhe të besueshme. Për më tepër, ajo duhet të ketë kapacitetin dhe zotësinë që rezultatet t'i bëjë publike në mënyrë të kuptueshme dhe t'i shpërndajë në një mënyrë sa më të përshtatshme për të lehtësuar përdorimin

#### Rast studimor 22

Në Republikën e Kirgizisë, me deklarinimin është ngarkuar Komisioni i Statistikave, ndërsa në Azerbajxhan këtë përgjegjësi e ka Komisioni Kombëtar për NTIN-ë. Në Nigeri, vendimi do të merret nga Grupi i Kombëtar i Punës i Palëve të Interesuara.

#### Rast studimor 24

Në Nigeri, palët e interesuara i kanë propozuar organizatës së ngarkuar me publikimin e informacioneve, që të parashikojë një sërë programesh që trajtojnë si bërjen publike, ashtu edhe sensibilizimin lidhur me NTIN-ë, përfshirë debate televizive, emisione radioje në gjuhët vendase, adresa në internet, broshura dhe seminare në mjedise shkollore dhe universitete.

nga publiku.

### Veprim i rekomanduar 20a: A është e nevojshme që, në Raportin për NTIN-ë, të paraqiten të dhëna totale apo të zbërthyer sipas zërave?

Palët e interesuara duhet të vendosin nëse dëshirojnë që publikimet e shoqërive dhe të qeverisë pritëse të vihen në dispozicion të publikut, duke i paraqitur si shuma të përgjithshme ose të zbërthyer në zëra të veçantë. Vendimi përfundimtar i takon qeverisë pritëse.

Në rastin e publikimit të shumës së përgjithshme, për çdo fluks avantazhi bëhet publike një shifër e vetme (e përgjithshme), ku është e nevojshme të bëhet kujdes që procesi i dhënies së shifrës së përgjithshme të konsiderohet i besueshëm.

32

#### Rast studimor 23

Në Azerbajxhan, duke patur parasysh shqetësimet e shprehura lidhur me klauzolat e konfidencialitetit të shoqërive, në ciklin e parë të deklarinimit është mbajtur një qëndrim i përgjithshëm.

Në Republikën e Kirgizisë, çështja e qëndrimit të përgjithshëm nuk shtrihet në të njëjtën mënyrë, meqenëse sektori dominohet nga një shoqëri e vetme.

## **Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime**

Në rastin e publikimit sipas zërave të caktuar, numri i përgjithshëm zërave në zëra të caktuar sipas shoqërisë dhe/ose lejes/koncesioneve, ku është e nevojshme të bëhet kujdes që shifrat e dhëna sipas zërave të jenë të krahasueshme dhe kuptimplote.

Parimi i NTIN-ësë është që ta arrijë objektivin e saj për një transparencë më të madhe duke respektuar kontratat dhe ligjet ekzistuese. Duhet patur veçanërisht kujdes që të ruhet ekuilibri mes kërkesës për publikim në kuadrin e NTIN-ësë dhe shqetësimeve për ruajtjen e konfidencialitetit tregtar të shoqërive.

## E. Shpërndarja e informacionit për publikun dhe diskutimi

### Veprim i rekomanduar 21: A është Raporti për NTIN-ë i arritshëm dhe i kuptueshëm?

#### Rast studimor 25

Sipas udhëzuesve për deklaratimet në kuadrin e NTIN-ësë, në Ganë, rezultatet duhet të jenë “të lehta për t’u kuptuar nga përdoruesit që kanë njohuri mesatare për sektorin minerar ... dhe janë të gatshëm ta studiojnë informacionin me mjaft vëmendje”. Në Nigeri, grupi konsultativ i punës deklaroi se rezultatet duhet të jenë “faktike, joshpjeguese dhe të thjeshta” dhe propozoi, bashkërisht me koalicionin në Azerbajxhan, që rezultatet të shoqërohen me një broshurë shpjeguese.

Vënia plotësisht në jetë e NTIN-ësë në tërësinë e saj kërkon publikimin e të gjitha pagesave dhe të ardhurave në një mënyrë të arritshme, të hollësishme dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

Në shumë vende, është e nevojshme që Raporti për NTIN-ë të botohet në internet, në adresën kombëtare për NTIN-ë, krijimi i të cilës rekomandohet që gjatë fazës së *nisjes*.

Gjatë procesit të shpërndarjes së rezultateve duhet të mbahet parasysh fakti se të gjitha palët e ndryshme të interesuara nuk kanë të njëjtën mundësi për t’i

përdorur të dhënat, prandaj është me interes që t’u bëhet thirrje gjithë mediave: gazetave, televizionit, radios dhe seminareve vendore.

### Veprim i rekomanduar 21a: A e lejojnë procedurat përhapjen e rezultateve në shkallë të gjerë?

#### Rast studimor 26

Në Republikën e Kirgizisë, Ministria e Financave parashikon të krijojë një shërbim komunikimi që ka për detyrë vendosjen e dialogut me publikun për menaxhimin e financave publike.

Që vënia në jetë e NTIN-ësë në një vend të mos jetë një veprimtari thjesht teknike e publikimit, është e rëndësishme që të sigurohet një përhapje në shkallë të gjerë e rezultateve, duke i vendosur të ardhurat nga nafta,

gazi dhe veprimtaritë minierare në kuadrin e menaxhimit global të financave publike. Qeveritë inkurajohen, në mënyrë të posaçme, që të zbatojnë parimet, që propozon “Kodi i praktikave të mira për çështje të transparencës së financave publike” të FMN-së, të përgatitjes, ekzekutimit dhe informimit buxhetor transparent, ndërkohë që ndërmarrin fushata botimi me synime të caktuara.

Shumica e vendeve që kanë filluar të zbatojnë NTIN-ë parashikojnë që të organizojnë një numër sesionesh dhe seminaresh – në nivel qendror dhe vendor – për të inkurajuar një paraqitje të përgjegjshme të çështjeve. Rezultatet duhet të jenë të kuptueshme për palët e interesuara, ku e rëndësishme është që të merren në konsideratë aspektet gjuhësore, kryesisht

## Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime

përkthimi në gjuhët vendase nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

**Veprim i rekomanduar 22: A kanë marrë pjesë palët kryesore të interesuara në ndonjë diskutim të rezultateve lidhur me të ardhurat dhe pagesat e deklaruara?**

Pasi rezultatet të bëhen pronë publike, qeveria duhet të tregohet proaktive dhe të organizojë një diskutim publik për të ardhurat që janë deklaruar. Që NTIN të jetë efikase, aktorët kryesorë duhet të jenë të aftë që t'i diskutojnë, t'i vlerësojnë dhe t'i interpretojnë rezultatet. Ky diskutim dëshmon vullnetin e qeverisë për të marrë përsipër përgjegjësitë e veta dhe për të dhënë llogari për të ardhurat e industrive nxjerrëse.

**Veprim plotësues A22: A është shtrirë ky diskutim në kuptim më të gjerë të palëve të interesuara?**

Pjesëmarrja e palëve të tjera të interesuara në fazën e diskutimit mund ta pasurojë procesin. Sa herë që të jetë e mundur, duhen parashikuar mekanizma që këto palë t'i ofrojnë pikëpamjet e tyre dhe të kontribuojnë për të interpretuar shifrat e deklaruara, sepse integrimi i kontributeve të tyre ka gjasa të sigurojë një mbështetje më të gjerë dhe të sigurojë legjitimitetin e procesit dhe të institucioneve të interesuara.

## **Shqyrtimi i zbatimit të NTIN-ësë**

### **F. Shqyrtimi**

**Veprim i rekomanduar 23: A janë marrë masa për ndjekjen dhe vlerësimin e NTIN-ësë?**

Shqyrtimi i procesit të NTIN-ësë bën të mundur që vendi të vlerësojë avantazhet e vënies në jetë, t'u tregojë të tjerëve performancat e vendit dhe të përqendrohet te përmirësimi i zbatimit në të ardhmen. Palëve kryesore të interesuara u takon që të vendosin termat e referencës përsa i përket shqyrtimit dhe të marrin pjesë në të (me anë të anketave ose intervistave). Gjatë kësaj faze, organizatat e shoqërisë civile, që ofrojnë një mbikëqyrje plotësuese të procesit, kanë rastin që të bashkëpunojnë ngushtë me qeverinë.

**Veprim plotësues A23a: A ekziston ndonjë mekanizëm formal i vlerësimit të pavarur?**

Ekzistenca e një mekanizmi formal të vlerësimit të pavarur ka si avantazh rritjen e besueshmërisë së procesit të NTIN-ësë në sytë e palëve të interesuara si atyre vendase, ashtu edhe atyre ndërkombëtare. Një vlerësues i pavarur mund të paraqesë një raport të paanshëm duke prekur thelbin e çështjeve të rëndësishme, domethënë, “A do të jetë i qëndrueshëm procesi?” dhe “Cilat janë mësimet që duhen nxjerrë për të përmirësuar rolin e qeverisë, të industrive nxjerrëse dhe të shoqërisë civile?”

**Veprim plotësues A23b: A u janë ofruar përvoja vendeve të tjera dhe palëve të interesuara?**

Shkëmbimi i mësimave që nxirren, me vendet e tjera që po vënë në jetë ose parashikojnë të vënë në jetë NTIN-ën, i ndihmon këto vende duke bërë të mundur që vendi, i cili i ofron këto përvoja, të marrë meritën e reformave që ka ndërmarrë. Sekretariatit të NTIN-ësë i takon të bashkërendojë shkëmbimin e përvojave – me anë të seminareve rajonale dhe botërore, rishikimit të librit të referencave dhe publikimit në adresën e internetit për NTIN-ën.

**Veprim i rekomanduar 24: A është ndikuar hartimi i procesit vendimmarrës dhe proceseve të tjera nga mekanizmat e dhënies së informacionit apo komenteve?**

Zbatimi i NTIN-ësë duhet të vazhdojë të përmirësohet duke u bazuar tek përvojat, sepse bëhet fjalë për një proces “të të mësuarit gjatë kryerjes së

## **Kapitulli 2: Udhëzues shpjegues për vendet e pasura në burime**

detyrës”. Efikasiteti dhe qëndrueshmëria e zbatimit kalojnë përmes shkëmbimit të opinioneve me palët e interesuara dhe integritit të komenteve të tyre.

## Kapitulli 3

### Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse

#### Tipare të përgjithshme

Zbatimi i NTIN-ësë u takon vendeve të ndryshme të pasura në burime. Sidoqoftë, gjatë hartimit të NTIN-ësë është pranuar fakti që shoqëritë luajnë gjithashtu një rol rëndësishëm në arritjen e objektivave të NTIN-ësë. Asnjë dallim nuk bëhet aktualisht mes shoqërive ndërkombëtare, kombëtare, shtetërore apo private, pavarësisht nga fakti se një numër veprimesh plotësuese që propozohen nuk janë të vlefshme për të gjitha shoqëritë (çështje kjo që do të bëhet objekt i trajtimit të mëtejshëm në botimet e ardhshme të librit).

Këta udhëzues pasqyrojnë rolet e ndryshme që mund të luajnë industritë nxjerrëse, duke bërë ndarjen e rolit për miratimin e NTIN-ësë, nga roli për të siguruar mbështetje në shkallë kombëtare (si për vendet zbatuese, ashtu dhe për vendet jozbatuese).

#### Përmbledhje e veprimeve të rekomanduara dhe veprimeve plotësuese të shoqërive

Duke pranuar natyrën vullnetare të NTIN-ësë, si edhe interesin e shoqërive të industrive nxjerrëse (dhe palëve të tjera të interesuara) për të përcaktuar masat që shoqëritë mund të marrin në mbështetje të NTIN-ësë, këta udhëzues identifikojnë veprimet (me sfond blu) që shoqëritë, të cilat mbështesin zbatimin e NTIN-ësë, inkurajohen të ndërmarrin që zbatimi të jetë efikas, si dhe veprimet plotësuese (me sfond të gjelbër) që ato mund të ndërmarrin për ta përmirësuar vënien në jetë të saj. Këto veprime mbështesin veprimet që përshkruhen te udhëzuesit shpjegues për vendet e pasura në burime.

Veprimet e shoqërive	Veprime plotësuese të shoqërive
<b>Miratimi</b>	
<b>A. Anëtarësimi</b>	
25. A ka bërë shoqëria ndonjë deklaratë të qartë publike lidhur me qëllimin e saj për të mbështetur vendet që kanë zgjedhur të vënë në zbatim NTIN-ë?	A25 A është e integruar NTIN në politikat dhe/ose sistemin e raportimit të brendshëm?
26. A ka emëruar shoqëria ndonjë person për të drejtuar procesin e zbatimit të NTIN-ësë?	

### Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse

<b>B. Mbështetja ndërkombëtare</b>	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrja e fjalës në konferenca;</li> <li>• Marrja e fjalës në konferenca brenda dhe jashtë vendit për temën e transparencës/ menaxhimit të të ardhurave dhe për temën e NTIN-ësë;</li> <li>• Bërja e komenteve për rishikimet e dokumenteve bazë, të cilat orientojnë vënien në jetë të NTIN-ësë;</li> <li>• Mundësimi i grumbullimit të shembujve të praktikave më të mira lidhur me NTIN-ë dhe sigurimi i përhapjes së tyre në shkallë botërore;</li> <li>• Evokimi i NTIN-ësë në kuadrin e ndërveprimit strategjik me qeverinë e tyre (ose çdo qeveri tjetër);</li> <li>• Të treguarit proaktiv kundrejt palëve të interesuara për të inkurajuar transparencën e të ardhurave;</li> <li>• Mbështetja e integritit të qasjeve të NTIN-ësë në praktikat më të mira dhe udhëzimet e industrive nxjerrëse; bashkëpunimi gjatë vënies në jetë të saj.</li> </ul>
<b>Mbështetja në nivel kombëtar</b>	
27. A i plotëson auditimi i shoqërisë standardet ndërkombëtare?	A27. A i ka inkurajuar shoqëria shoqëritë e tjera që të rekomandojnë një transparencë më të madhe?
<b>C1. Vendi zbatues</b>	
28. A ka qenë shoqëria gjatë fazës së nisjes së NTIN-ësë plotësisht e angazhuar në vendet zbatuese ku ajo vepron?	
29. A ka qenë shoqëria gjatë fazës së zbatimit të NTIN-ësë plotësisht e angazhuar në vendet zbatuese ku ajo vepron?	
30. A ka qenë shoqëria gjatë fazës së shyrtimit të NTIN-ësë plotësisht e angazhuar në vendet zbatuese ku ajo vepron?	

### Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse

#### C2. Vendi jozbatues

- Diskutimi i transparencës me donatorët e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare;
- Organizimi i seminareve.

### Miratimi

#### A. Anëtarësimi

**Veprim i shoqërive 25: A ka bërë shoqëria ndonjë deklaratë të qartë publike lidhur me qëllimin e saj për të mbështetur vendet që kanë zgjedhur të vënë në zbatim NTIN-ë?**

Të gjitha shoqëritë e industrive nxjerrëse inkurajohen që të miratojnë parimet dhe kriteret e NTIN-ësë. Gjithashtu, shoqëritë inkurajohen që të tregojnë vullnetin e tyre për të mbështetur vendet, të cilat kanë zgjedhur që të vënë në jetë NTIN-ë. Duke patur parasysh faktin se përgjegjësia e vënies në jetë i bie kryesisht vendit në fjalë, shoqëritë duhet të shmangin çdo veprim që krijon përshtypjen e ushtrimit të presionit ndaj vendeve pritëse.

Deklarata e miratimit, që bëhet nga drejtori ekzekutiv ose ndonjë përfaqësues i deleguar, duhet të publikohet në adresën e internetit të shoqërisë dhe/ose në një raport vjetor; një kopje e deklaratës duhet t'i dërgohet Sekretariatit Ndërkombëtar të NTIN-ësë me qëllim që ta botojë në adresën e internetit për NTIN-ë. Deklarata mund të përmbajë një listë të vendeve, në të cilat shoqëria është e pranishme dhe ka synimin që ta mbështesë vënien në jetë të NTIN-ësë.

**Veprim plotësues i shoqërive A25: A është e integruar NTIN në politikat dhe/ose sistemin e raportimit të brendshëm?**

Një shoqëri mund të parashikojë përfshirjen e parimeve dhe kriterëve të NTIN-ësë në politikën e vet të përgjithshme ose në raportimin e brendshëm. Përveç kësaj, shoqëritë mund të parashikojnë informimin e personelit të tyre lidhur me mundësitë për të mbështetur vënien në jetë të NTIN-ësë në vendet zbatuese, në të cilat ato janë të pranishme.

**Veprim i shoqërive 26: A ka emëruar shoqëria ndonjë person për të drejtuar procesin e zbatimit të NTIN-ësë?**

Shoqëria duhet të emërojë një kuadro të lartë për të drejtuar procesin e zbatimit të NTIN-ësë dhe sensibilizimin në opinion publik. Kjo mund të parashikojë publikimin e emrit dhe të të dhënave të personit përgjegjës në adresën e vet të internetit.

#### B. Mbështetja ndërkombëtare

Në zyrën kryesore dhe/ose në nivel ndërkombëtar, shoqëritë e kanë mundësinë që të mbështesin hartimin dhe përmirësimin e NTIN-ësë, mes të tjerash, nëpërmjet veprimeve të mëposhtme:

- Marrja e fjalës në konferenca brenda dhe jashtë vendit për temën e transparencës/ menaxhimit të të ardhurave dhe për temën e NTIN-ësë.
- Bërja e komenteve për rishikimet e dokumenteve bazë, të cilat orientojnë vënien në jetë të NTIN-ësë.

### **Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse**

- Mundësimi i grumbullimit të shembujve të praktikave më të mira lidhur me NTIN-ë dhe sigurimi i përhapjes së tyre në shkallë botërore.
- Evokimi i NTIN-ësë në kuadrin e ndërveprimit strategjik me qeverinë e tyre (ose çdo qeveri tjetër).
- Të treguarit proaktiv kundrejt palëve të interesuara për të inkurajuar transparencën e të ardhurave.
- Mbështetja e integritit të qasjeve të NTIN-ësë në praktikat më të mira dhe udhëzimet e industrive nxjerrëse; bashkëpunimi gjatë vënies në jetë.

### **Mbështetja në nivel kombëtar**

#### **Veprim i shoqërive 27: A i plotëson auditimi i shoqërisë standardet ndërkombëtare?**

Mund të pritet që shoqëritë ndërkombëtare të respektojnë normat në fushën e transparencës dhe bërjes publike, të cilat kanë të bëjnë me auditimin, duke ndjekur parimet për drejtimin e shoqërisë të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD). Gjithashtu, për shkak të rregullave në fushën e kuotimit në bursë, këto shoqëri normalisht kanë detyrimin që t'u përmbahen normave të kontabilitetit dhe të auditimit të pranuar në shkallë ndërkombëtare, përfshirë rekomandimet e Deklaratës për Praktikën e Këshilluar të Komisionit Kontabël të Industrisë së Naftës (2001).

Projektudhëzuesi i FMN-së rekomandon që shoqëritë kombëtare dhe shtetërore duhet të kenë detyrimin që të respektojnë normat universale në fushën e auditimit dhe këtu mund të vihet një shënim për mbikëqyrje nga ana e Kontrollit të Lartë, kur mandati i këtij institucioni shtrihet te auditimi i shoqërive shtetërore.

Një shoqëri duhet të reagojë pozitivisht dhe publikisht ndaj gjithë ndryshimeve të ndërmarra nga ana e qeverisë pritëse në favor të një transparence më të madhe. Sipas rastit, ajo mund të ndërmarrë veprime në bashkëpunim me shoqëritë e tjera që veprojnë në vend.

#### **Veprim plotësues i shoqërive A27: A i ka inkurajuar shoqëria shoqëritë e tjera që të rekomandojnë një transparencë më të madhe?**

Disa shoqëri janë të afta t'i inkurajojnë shoqëritë e tjera që veprojnë në këto vende, që t'u japin përgjigje pozitive përpjekjeve të vendit pritës, duke manifestuar në këtë mënyrë gjithë kontributin që ka dhënë sektori në ekonominë e qeverisë pritëse. Kjo mund të ndodhë për shkak të pozicionit të tij në një vend, apo për shkak të rolit të tij në sipërmarrjet e përbashkëta. Kur një qeveri pritëse vendos të vërë në jetë NTIN-ë, ndërmarrjet që e njohin më mirë NTIN-ë duhet të ngarkohen të bëjnë informimin e shoqërive të tjera që veprojnë në vend, të cilat nuk janë në dijeni të nismës.

## Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse

### C1. Vendi zbatues

Sipas parimeve të NTIN-ësë, të gjitha shoqëritë e industrive nxjerrëse në një vend zbatues duhet të kenë detyrimin që të paraqesin deklarime. U përket vendeve zbatuese që të përcaktojnë mënyrën më të mirë për marrjen e deklarimit të çdo shoqërie në kohën e duhur: marrëveshje vullnetare apo krijimi i një kuadri ligjor në funksion të rrethanave të vendit [veprim i rekomanduar për 17b].

Në qoftë se vendi, në të cilin vepron një shoqëri, ka zgjedhur ta vërë në jetë NTIN-ë, është normale që shoqëria të marrë pjesë në përpjekjet e vendit që në fillim të procesit. Përgjegjësitë kryesore të shoqërive kanë të bëjnë me përgatitjen e deklarimeve sipas modeleve [shih Veprime të rekomanduara për vendet në pjesët C dhe D – zhvillimi i procesit]. Ndërsa janë palë të interesuara, shumica e shoqërive duhet të luajnë rolin e tyre edhe në aspekte të tjera të zbatimit.

**Veprim i shoqërive 28: [Nisja në vend]: A ka qenë shoqëria gjatë fazës së nisjes së NTIN-ësë plotësisht e angazhuar në vendet zbatuese ku ajo vepron?**

Për t'u angazhuar pa rezerva përsa i përket nisjes:

- A ka përcaktuar shoqëria – dhe parashikuar në buxhetin e saj – shpenzime (kosto të drejtëpërdrejta, krijimi i kapaciteteve, shpenzime jo të drejtëpërdrejta, të tilla si koha e punës e personelit) për pjesëmarrjen e saj në përgatitjen e deklarimeve lidhur me NTIN-ë dhe për elementë të tjerë të procesit të NTIN-ësë [veprim i parashikuar për vendet 15]?
- A ka marrë pjesë shoqëria në emërimin e një administratori dhe/ose revizori [veprim i parashikuar për vendet C13]?
- A ka vendosur shoqëria kontakt me palët e interesuara për t'i ndihmuar që të kuptojnë transparencën e të ardhurave [veprim i rekomanduar për mbështetjen e vendeve 11]?
- A ka vendosur shoqëria kontakt me palët e interesuara për të vlerësuar nevojat e tyre në fushën e krijimit të kapaciteteve; a ka vendosur ajo për mbështetjen që mund të jepte në raport me veprimin e rekomanduar për vendet 16?

**Veprim i shoqërive 29: [Zbatimi në vend]: A ka qenë shoqëria gjatë fazës së zbatimit të NTIN-ësë plotësisht e angazhuar në vendet zbatuese ku ajo vepron?**

Për t'u angazhuar pa rezerva përsa i përket zbatimit:

- A ka nisur shoqëria dialogun me qeverinë lidhur me krijimin e modeleve të deklarimit [veprim i rekomanduar për vendet 12]?

### Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse

- A ka marrë ajo ndonjë vendim përsa i përket publikimit (shumat e përgjithshme kundrejt zërthimit në zëra të veçantë) [veprim i rekomanduar për vendin 20a]?
- A është arritur ndonjë konsensus përsa i përket zgjedhjes së flukseve të avantazheve që duhen deklaruar [veprim i rekomanduar për vendin 17a]?
- A është arritur ndonjë konsensus përsa i përket zërthimit të shumave në zëra të veçantë: sipas niveleve të qeverisë dhe sipas llojit të pagesës (e drejta e prodhimit, renta e pasurisë minerare, tarifatat etj.) [veprim i rekomanduar për vendin 17a]?
- A paraqitet informacioni i shoqërisë në formatin e pranuar – duke ruajtur sistemin, periodicitetin, metodën e kontabilitetit dhe njësinë e kontabilitetit, për të cilat është rënë dakord [veprimi i rekomanduar për vendin 17c]?
- A e ka ngarkuar shoqëria revizorin e saj të jashtëm të bëjë auditimin e pagesave të saj (nga arka) për vendet zbatuese [kriteret e NTIN-ësë 2]?
- A ka marrë pjesë shoqëria në emërimin e ndonjë agjencie të besueshme dhe të paanshme, të ngarkuar me publikimin [veprim i rekomanduar për vendet 20]?
- A ka marrë pjesë shoqëria në shpërndarjen e rezultateve për publikun dhe në diskutimin e tyre [veprim i rekomanduar për vendet 22]?

**Veprim i shoqërive 30: [Shqyrtimi në vend] A ka qenë shoqëria gjatë fazës së shqyrtimit të NTIN-ësë plotësisht e angazhuar në vendet zbatuese ku ajo vepron?**

Për t'u angazhuar pa rezerva përsa i përket shqyrtimit:

- A ka marrë pjesë shoqëria në përcaktimin e termave të referencës për shqyrtimin [veprim i rekomanduar për vendet 23]?
- A i ka formuluar dhe shkëmbyer shoqëria përvojat nga pjesëmarrja e saj në NTIN-ë si në planin kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar [veprim i rekomanduar për vendet 23 dhe veprim plotësues për vendet A23b]?

## C2. Vend jozbatues

### **Kapitulli 3: Udhëzues shpjegues për shoqëritë e industrive nxjerrëse**

- Meqenëse një pjesë e madhe e dialogut lidhur me transparencën ka gjasa të zhvillohet qeveri me qeveri, apo gjatë diskutimeve të rregullta mes qeverive ose organizatave ndërkombëtare, një shoqëri mund të parashikojë që të ngrëjë çështjen e transparencës me donatorët dhe me organizatat ndërkombëtare me qëllim që të demonstruar angazhimin e saj në favor të transparencës.
- Një shoqëri mund t'i diskutojë opsionet dhe hapat e ardhshme me një numër palësh të interesuara, ndër to dhe organizata të shoqërisë civile, si pjesëmarrëse ose bashkëorganizatore të ndonjë seminari.

### Terminologjia

Termi	Përkufizimi
Kontabilitet me të drejta dhe detyrime të konstatuara	Sistem kontabël tipik për shoqëritë, në të cilat të ardhurat konstatohen si të tilla pasi fitohen, dhe shpenzimet konstatohen si të tilla pasi kryhen. Ai ndryshon nga kontabiliteti mbi bazën monetare, që i konstaton transaksionet pasi fondet merren ose paguhen.
Organi administrativ (ose administratori)	Palë e tretë e pavarur, e cila është përgjegjëse për grumbullimin dhe analizën e raporteve që paraqesin shoqëritë dhe qeveritë pritëse.
Auditimi	Inspektim i llogarive të një organizate, kryesisht nga një organizëm i pavarur.
Fluksi i avantazheve	Burim i mundshëm i avantazheve ekonomike që qeveria pritëse merr nga industritë nxjerrëse.  Avantazhet ekonomike jo të drejtëpërdrejta, të tilla si ndërtimi i infrastrukturave dhe punësimi i personelit vendor, nuk merren në konsideratë për qëllimin e këtyre udhëzuesve raportues si fluksi i avantazheve.
Kontabiliteti mbi bazën monetare	Sistem kontabël, i cili përdoret në përgjithësi nga qeveritë, rekomandohet për deklarimin lidhur me NTIN-ë, dhe regjistrin vetëm pagesat në para dhe hyrjet lidhur me transaksionet e një biznesi, ndryshe nga kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara, që të ardhurat i konstaton si të tilla pasi fitohen, dhe shpenzimet i konstaton si të tilla pasi kryhen.
Industritë nxjerrëse	Industri nxjerrëse janë ato industri që merren me lokalizimin dhe largimin e burimeve të dëmshme natyrore, që gjenden në koren e tokës ose në afërsi të saj. Burimet e dëmshme natyrore janë ato burime që qeniet njerëzore nuk janë të afta t'i zëvendësojnë në gjendjen e tyre origjinale.
Raporti për NTIN-ë	Raport që përgatit administratori në kuadrin e zbatimit të NTIN-ësë, për pagesat dhe të ardhurat.
Vendi pritës	Kufijtë territorialë në juridiksionin e një qeverie pritëse, brenda të cilëve një shoqëri ka interesa ekonomike lidhur me industrinë nxjerrëse.
Qeveria pritëse	Regjimet dhe institucionet e qeverisë së një shteti, brenda kufijve territorialë të së cilës veprojnë shoqëritë e industrive nxjerrëse. Në qeverinë pritëse përfshihen përfaqësuesit vendorë, rajonalë, shtetërorë dhe federalë të këtyre regjimeve, institucioneve dhe subjekteve, që kontrollohen nga këto regjime dhe institucione, por këtu përjashtohen shoqëritë shtetërore kombëtare.
Shoqëri ndërkombëtare	Duke u bazuar në qëllimin e të këtij libri referencash, në kategorinë e shoqërive ndërkombëtare përfshihen: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shoqëritë publike dhe private që aktivizohen në veprimtaritë më afër burimit të industrive nxjerrëse jashtë kufijve territorialë të vendit ku kanë selitë.</li> <li>• Shoqëritë shtetërore që veprojnë jashtë kufijve territorialë të qeverisë që i kontrollojnë.</li> </ul>

## Terminologjia

Termi	Përkufizimi
Leja (e shfrytëzimit)	Marrëveshje mes një shoqërie të industrive nxjerrëse dhe qeverisë pritëse lidhur me një zonë specifike gjeografike ose gjeologjike për shfrytëzimin e mineraleve. Duke u bazuar në qëllimin e këtij libri referencash, termi vlen gjithashtu për një leje, një të drejtë të sipërfaqes, një zonë të kontratës, një koncesion apo bllok.
Shoqëri kombëtare	Duke u bazuar në qëllimin e këtij libri referencash, kategoria e shoqërive kombëtare përfshin shoqëritë publike dhe private që aktivizohen në veprimtari më afër veprimtarive të industrive nxjerrëse brenda kufijve territorialë të vendit, në të cilin kanë selitë.
Shoqëri shtetërore kombëtare	Shoqëria e kontrolluar nga qeveria pritëse, e cila kryen veprimtari më afër industrive nxjerrëse në vendin pritës. Një shoqëri është e kontrolluar në masën që qeveria pritëse ka aftësinë t'i orientojë politikën e saj financiare dhe të shfrytëzimit, me qëllim që të nxjerrë përfitime nga veprimtaritë e saj.
Pagesat	Për qëllimin e NTIN-ësë, kategoria e pagesave përfshin të gjitha pagesat dhe materialet lidhur me prodhimin e naftës, gazit dhe me veprimtaritë minerare, që bëjnë shoqëritë në qeveri.
Marrëveshje për ndarjen e prodhimit	Marrëveshje mes qeverisë pritëse dhe një investitori, që i jep investitorit të drejtën ekskluzive për kërkimin, zhvillimin dhe nxjerrjen e mineraleve në këmbim të një pjese të prodhimit.
Subjekti raportues	Shoqëri dhe qeveri, të cilat i përgatisin dhe paraqesin deklaratimet sipas modeleve.
Modelet e deklaratimit	Modele, të cilat shoqëritë ndërkombëtare, kombëtare dhe shtetërore, si dhe qeveritë pritëse i përdorin për deklaratimet që i paraqesin administratorit në kuadrin e vënies në jetë të NTIN-ësë.
Të ardhurat	Për qëllimin e NTIN-ësë, kategoria e të ardhurave përfshin të gjitha të ardhurat materiale që kanë marrë qeveritë nga shoqëritë e naftës, gazit dhe pasurive minerare.
Veprimtari nxjerrëse	Kategoria e veprimtarive nxjerrëse përfshin të gjithë veprimtaritë lidhur me zbulimin, zhvillimin dhe prodhimin nga burimet minerare deri në çastin kur mineralet e nxjerra janë në një gjendje të tregtueshme pa përpunim të mëtejshëm.

## Shtojcë: Shembuj të modeleve të deklarimit

### Shtojcë

#### Shembuj të modeleve të deklarimit

Këto modele të deklarimit janë përgatitur për qëllimin e NTIN-ësë në vitin 2003. Shembuj të tjerë dhe informacion plotësues për modelet e deklarimit gjenden në adresën: <http://www.eitransparency.org/reportingguidelines.htm>

#### A. Model deklarimi me informacione për një njësi deklaruese të qeverisë pritëse (naftë ose gaz)

Vendi pritës deklaron më:

\_\_\_\_\_  
Periudha e deklarimit:

#### Objekti 1 Flukset e avantazheve

Nr.	Udhëzues Pjesa 6 ref	Volumi	Vlera
<b>1</b>	<b>Fluksi i avantazheve vetëm nga shoqëritë ndërkombëtare</b>		
1a)	E drejta e prodhimit e qeverisë pritëse ndaj shoqërive ndërkombëtare		
i)	Fluksi i prodhimit – në natyrë		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
ii)	Fluksi i prodhimit – me para në dorë		
<b>2</b>	<b>Fluksi i avantazheve nga shoqëritë shtetërore kombëtare</b>		
2a)	E drejta e prodhimit e qeverisë pritëse ndaj shoqërive shtetërore kombëtare	i	
i)	Fluksi i prodhimit – në natyrë		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
ii)	Fluksi i prodhimit – me para në dorë		
<b>3</b>	<b>Flukset e avantazheve të një shoqërie shtetërore ndërkombëtare dhe kombëtare</b>		
3a)	Tatimi mbi fitimin	iii	
3b)	Renta e pasurisë minerare	iv	
	- me para në dorë		
	- në natyrë		
3c)	Dividendët	v	
3d)	Bonuse të nënshkrimit dhe bonuse të prodhimit	vi	

## Shtojcë: Shembuj të modeleve të deklarimit

Nr.	Udhëzues Pjesa 6	Volumi	Vlera
	ref		
3e)	Tarifa për leje, tarifa për qira, "të drejtat e hyrjes" dhe shpërblime të tjera për leje dhe/ose koncesione	vii	
3f)	Pagesa të tjera për qeveritë pritëse, të përcaktuara si: _____ _____ _____	viii	

### Objekti 2 Flukset e avantazheve

Nr.	Volumi	Vlera
4	<b>Objekti 2 Flukset e avantazheve (publikimi në mënyrë vullnetare):</b> _____ _____ _____ _____ _____	

### Mbyllja nga ana e qeverisë pritëse

Ne pranojmë përgjegjësinë tonë në paraqitjen e drejtë të modelit të deklarimit në përputhje me direktivat e deklarimit, me përjashtim të:

- \_\_\_\_\_;
- \_\_\_\_\_;
- \_\_\_\_\_;
- \_\_\_\_\_.

**Shtojcë: Shembuj të modeleve të deklarimit**

**B. Model deklarimi me informacione për njësitë deklaruese (shoqëri të naftës dhe gazit)**

Emri i shoqërisë:

Vendi pritës deklaron më:

Periudha e deklarimit:

**Objekti 1 Flukset e avantazheve**

Nr.	Udhëzues Pjesa 6 ref	Volumi	Vlera
<b>1</b>	<b>Fluksi i avantazheve që duhet deklaruar vetëm nga shoqëritë ndërkombëtare</b>		
1a)	E drejta e prodhimit e qeverisë pritëse ndaj qeverisë pritëse i) Fluksi i prodhimit – në natyrë * [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisë] * [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisë] ii) Fluksi i prodhimit – me para në dorë	i	
1b)	E drejta e prodhimit e qeverisë pritëse ndaj një shoqërie shtetërore kombëtare i) Fluksi i prodhimit – në natyrë * [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisë] * [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisë] ii) Fluksi i prodhimit – me para në dorë	i	
<b>2</b>	<b>Fluksi i avantazheve që duhet deklaruar vetëm nga shoqëritë shtetërore kombëtare</b>		
2a)	i) Pjesa e aksioneve të shoqërive shtetërore kombëtare në të drejtën e prodhimit të qeverisë pritëse – në natyrë * [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisë] * [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisë] ii) Pjesa e aksioneve të shoqërive shtetërore kombëtare në të drejtën e prodhimit të qeverisë pritëse – me para në dorë	i	
2b)	Prodhimi që merret nga fluksi i prodhimit të shoqërisë shtetërore kombëtare – në natyrë	i	

## Shtojcë: Shembuj të modeleve të deklarimit

### Objekti 1 Flukset e avantazheve (vazhdim)

Nr.	Udhëzues	Volumi	Vlera
<b>Pjesa 6 ref</b>			
2c)	E drejta e prodhimit e një shoqërie shtetërore kombëtare <sup>1</sup>		
	i) E drejta e prodhimit – në natyrë	ii	
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
	ii) E drejta e prodhimit – me para në dorë	ii	
2d)	E drejta e prodhimit që është marrë për llogari të qeverisë pritëse	i	
	i) Fluksi i prodhimit – në natyrë		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
	* [përcaktoni qartë natyrën e prodhimit dhe të njësisve]		
	ii) E drejta e prodhimit që është marrë për llogari të qeverisë pritëse – me para në dorë	i	
<b>3 Pagesa për qeverinë pritëse/për shoqërinë shtetërore kombëtare</b>			
3a)	Tatimi mbi fitimin	iii	
3b)	Renta e pasurisë minerare	iv	
	- me para në dorë		
	- në natyrë		
3c)	Dividendët	v	
3d)	Bonuse të nënshkrimit dhe bonuse të prodhimit	vi	
3e)	Tarifa për leje, tarifa për qira, "të drejtat e hyrjes" dhe shpërblime të tjera për leje dhe/ose koncesione	vii	
3f)	Pagesa të tjera për qeveritë pritëse, të përcaktuara si:	viii	
	_____		
	_____		
	_____		

### Objekti 2 Flukse të avantazheve

Nr.	Volumi	Vlera
4	Objekti 2 Flukse të avantazheve (publikimi në mënyrë vullnetare):	
	_____	
	_____	
	_____	
	_____	

#### Mbyllja nga ana e drejtuesve

Ne pranojmë [ose, në emër të këshillit të administrimit (ose një organi të ngjashëm) ne pranojmë] përgjegjësinë tonë në paraqitjen e drejtë të modelit të deklarimit në përputhje me direktivat e deklarimit, me përjashtim të:

- \_\_\_\_\_;
- \_\_\_\_\_;
- \_\_\_\_\_;

<sup>1</sup> E drejta e një shoqërie shtetërore kombëtare lidhet me pjesën e saj të prodhimit në rastin kur ajo është pjesë kontraktuese, mes të tjerash, në rastin e pjesëmarrjes në një leje/koncesion, përveç të drejtës së prodhimit të qeverisë pritëse.

**Shtojcë: Shembuj të modeleve të deklarimit**

- \_\_\_\_\_.

**C. Modele për shumat e përgjithshme të shoqërive (shoqëri minerare)**

Vendi pritës deklaron më:

Periudha e deklarimit:

**Objekti 1 Flukset e avantazheve**

Nr.		Udhëzues Pjesa 6	Volumi	Vlera
		ref		
<b>1</b>	<b>Flukset e avantazheve nga një shoqëri shtetërore ndërkombëtare dhe kombëtare</b>			
1a)	Tatimi mbi fitimin	i		
1b)	Renta e pasurisë minerare - me para në dorë - në natyrë	ii		
1c)	Tarifa për leje, tarifa për qira, “të drejtat e hyrjes” dhe shpërblime të tjera për leje dhe/ose koncesione	iii		
1d)	Bonuse të nënshkrimit dhe bonuse të prodhimit	vi		
1e)	Dividendët	vii		
1f)	Pagesa të tjera për qeveritë pritëse, të përcaktuara si (përfshirë pagesat e bëra nëpërmjet prodhimit):  _____ _____ _____	iv, v, viii		

## **Shtojcë: Shembuj të modeleve të deklarimit**

### **Botuar nga Ministria Britanike për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID)**

Selia e DFID-së ndodhet në adresën:

1 Palace Street  
London SW1E 5HE  
Mbretëria e Bashkuar

Dhe në adresën:

Abercrombie House  
Eaglesham Road  
East Kilbride  
Glasgow G75 8EA  
Mbretëria e Bashkuar

Tel: +44 (0) 20 7023 0000  
Fax: +44 (0) 20 7023 0016  
Adresa e internetit: [www.dfid.gov.uk](http://www.dfid.gov.uk)  
E-mail: [enquiry@dfid.gov.uk](mailto:enquiry@dfid.gov.uk)  
Zyra e informacionit: 0845 3004100  
Ose: +44 1355 84 3132 (nëse merrni nga jashtë)

© E drejta e autorit është e Kurorës, viti 2005

Foto në kopertinën e parë: © Yola Monakhov/Panos.  
E drejta e autorit lidhur me faqosjen dhe kompozimin tipografik i takon Kurorës. Ky botim (me përjashtim të shenjës dalluese) mund të riprodhohet falas në çfarëdo forme ose me çfarëdo material, me kusht që ai të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në ndonjë kontekst të gabuar. Duhet të përmendet e drejta e autorit që ka Kurora për materialet, ndërsa titulli e burimi i publikimit duhet të përcaktohen qartë

Botuar nga Ministria Britanike për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID). Shtypur në Mbretërinë e Bashkuar, në vitin 2005, me material të ricikluar që përmban 80% mbetje pas konsumit dhe 20% brumë letre të pastër nga klori.

Referenca e prodhimit: PD 042  
ISBN: 1 86192 707 X